



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS



Dhjetor, 2010
Gjakovë



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Hyrje

Ne baze te nenit 58 pika (j) te Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 41 pika (j) të Statutit të Komunës, kryetari i Komunës se Gjakovës i dërgon Kuvendit të Komunës për periudhën janar-Nëntor 2010 këtë:

RAPORT

PER SITUATEN EKONOMIKO-FINACIAR

Institucionet komunale kanë vazhduar me punën, përkushtimin profesional dhe ligjor në realizimin e të gjitha objektivave që dalin nga dokumentet programore të qeverisjes lokale të komunës së Gjakovës.

Duke u bazuar në Strategjinë e zhvillimit ekonomik të komunës së Gjakovës, objektivat e qeverisë lokale gjatë kësaj periudhe kanë qenë të orientuara në :

- Zhvillimin, promovimin dhe rigjenerimin e infrastrukturës lokale
- Përmirësimi i ambientit për të jetuar
- Zhvillimi i sferës së Shëndetësisë, arsimit, kulturës dhe sportit
- Përkrahja dhe zhvillimi i biznesit
- Zbutja e papunësisë dhe luftimi i varfërisë
- Rritja e qëndrueshmërisë së buxhetit komunal

Në bashkëpunim me Organizatën EULOG-un, është formuar Këshilli për Zhvillimin dhe implementimin e Strategjisë së zhvillimit ekonomik të komunës së Gjakovës, duke kërkuar mënyra dhe forma të ndryshme për tërheqjen e investimeve të huaja për investime kapitale duke u bazuar në Projektet dhe Programet zhvillimore që disponon Komuna e jonë sipas dikastereve përkatëse.

Zhvillimi ekonomik është synim i Qeverisë lokale në Gjakovë, krijimi i vendeve të reja të punës dhe zgjerimi i bazës ekonomike materiale të banorëve të komunës sonë duke ngritur edhe mirëqenien njerëzore.

Jemi në fazën e rritjes së dinamikës së realizimit të punëve në vazhdim në mënyrë që të gjitha projektet të realizojmë në afatet e duhura dhe në pajtim me rregullativën ligjore.

Gjatë kësaj periudhe Komuna e Gjakovës ka realizuar të hyrat vetanake në shumë prej: 2.265.391,44 € apo 93,75% nga Drejtoritë që participojnë në krijimin e të hyrave vetanake, konform Rregulloreve komunale mbi tarifat dhe ngarkesat.

Me këtë rast vlen të theksohet edhe kontributi i banorëve të komunës sonë në gatishmërinë e tyre për të paguar tatimin në pronë, i cili për këtë periudhë është realizuar në vlerë prej: 659.541,57 € ose 117,36%.

Kjo pagesë e tatimit në pronë iu rikthehet banorëve të komunës në Investime kapitale në infrastrukturën komunale siç janë: ndërtimi i rrugëve, kanalizimeve, ujësjellësve etj. Sa i përket shpenzimeve gjatë kësaj periudhe Komuna ka shpenzuar :

Gjatë periudhës Janar - Nëntor 2010 janë alokuar mjete buxhetore për Komunën tonë në shumë prej: 14.353.66175, € ndërsa janë shpenzuar shuma prej: 13.721.386,22 €, apo 95,60% nga mjetet e alokuara. Nga këto shpenzime buxhetore, vetëm për investime kapitale janë investuar shuma prej: 4.963.894,02 €, për projekte te ndryshme kapitale.

Komuna e jonë ka vazhduar bashkëpunimin e mirë me subjektet relevante vendore dhe ndërkombëtare. Bashkëpunimi me Institucionet Qendrore ka qenë në nivelin e duhur sipas dikastereve të ministrive përkatëse. Pastaj bashkëpunimi me ICO, KFOR, USAID, OSCE, Ambasada dhe asociacione tjera ndërkombëtare.

1. DREJTORIA PËR PUNË TË PËRGJITHSHME ADMINISTRATIVE

Në pajtim me politikat programore kemi filluar rritjen e disiplinës në punë, duke e kthyer administratën publike komunale në servis për qytetarët pa dallim etnie, feje, grupi apo gjini dhe duke e rritur efikasitetin e punës së administratës komunale në përgjithësi dhe administratës së përgjithshme në veçanti. Me qëllim të efikasitetit më të madh dhe transparencës, kemi përfunduar ndërtimin e tri Zyra të Vendit, në Ponoshec, Gërgoc dhe Skivjan të cilat së shpejti do të fillojnë punën në fillim të vitit 2011, ndërsa kemi filluar edhe ndërtimin e Zyrës së Vendit në fshatin Molliq.

a. SEKTORI I STATUSIT CIVIL

Shërbimi i ofiqarisë është vënë tërësisht në funksion të qytetarëve. I kemi zvogëluar në minimum pritjet, zvarritjet dhe sjelljet në kundërshtim me etikën e punës.

Gjatë periudhës raportuese janë kryer këto shërbime:

Regjistrimet e reja dhe të mëvonshme LAL – 49.021

Regjistrimet e reja dhe të mëvonshme në LAM - 860

Regjistrime e reja dhe të mëvonshme në LAV - 524

Certifikata: LAL – 45.590, LAM – 6.520, LAV - 2.390

Të hyrat e Drejtorisë së Administratës së përgjithshme për periudhën Janar – Nëntor – 2010

REALIZIMI I TE HYRAVE SIPAS DREJTORIVE TE KK GJAKOVË NËNTOR - 2010				
Nr	BURIMET E TË ARDHURAVE	Planifikimi i periudhes Janar-Nëntor - 2010	Realizimi per periudhen Janar-Nëntor 2010	% e realizimit Janar-Nëntor
7	Administrata e përgjithshme	107,200.00	109,187.50	101.85%
a	Qertifikatat e lindjes,vdekjes etj	40,700.00	37,156.00	91.29%
b	Qertifikatat e kurorizimit	23,300.00	15,284.00	65.60%
c	Qertifikatat tjera	15,500.00	24,984.50	161.19%
d	Vertetime te dok ndryshme,shkresa ankesa	12,800.00	15,732.00	122.91%
e	Taksa administrative te ndryshme	6,300.00	8,293.00	131.63%
f	Prokurimi-Të hyrat nga shpallja e tenderëve	8,600.00	7,738.00	89.98%

Shpenzimet e Drejtorisë së Administratës së përgjithshme për periudhën Janar – Nëntor – 2010

Nr	Buxheti sipas kategorive	Buxheti	Alokimet	Mbetet për tu alukuar	Shpenzimet	Zotimet	Mbetja	%,shpenz. me alokime
1	PAGAT	167,380.00	152,807.98	14,572.02	150,054.69		2,753.29	98.20
2	M & SHËRBIME	101,792.00	101,792.00		98,088.25	3,697.92	5.83	96.36
3	KOMUNALIT	148,000.00	148,000.00		147,946.75	12.34	40.91	99.96
4	KAPITALET	39,640.46	39,640.46		9,950.11	29,690.00	0.35	25.10
5	DONACION							#DIV/0!
	Gjithsej	456,812.46	442,240.44	14,572.02	406,039.80	33,400.26	2,800.38	91.81

c. ZYRA PËR BARAZI GJINORE

Aktivitetet e kësaj zyre në kuadër të NJDNJ gjatë periudhës Janar- Dhjetor janë të shumta:

Në këtë kuadër, kjo zyrë merret me aktivitetet që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe përkrahjen e të drejtave të grave, fëmijëve dhe dhunën në baza gjinore, në përkrahjen e projekteve të OJQ-ve në promovimin e barazisë gjinore, aktivitetet e grumbullimit të të dhënave bazuar në moshë, gjini dhe etni të grupeve (komuniteteve), rastet e dhunës në familje, bashkërendimin e punëve dhe bashkëpunimin e mirëfilltë me të gjitha drejtoritë që prekin në fushën e barazisë gjinore, këshillimin për rastet e grave të ndara nga bashkëshortët, lidhur me përfitimin e ndihmave sociale, krijimin e partneritetit me subjektet relevante në komunë.

Përpos kësaj kjo zyrë ka zhvilluar këto aktivitete:

Shënimin e ditës ndërkombëtare të gruas “8Marsin”

Gjatë periudhës janar-dhjetor janë organizuar 6 takime (mbledhjeve) informativo-konsultativ me OJQ-të lok të grave K. Gjakovës.

Dhënia e informatave dhe njoftimeve të ndryshme në DNJDNJ - MAPL dhe në Agjencinë për Barazi Gjinore, si dhe plotësimin e pyetësorëve;

Bashkëpunimi i rregullt i NJDNJK me Institucionin e Ombudspersonit.

*Si ZBGJ kam marrë pjesë nëpër panelet e intervistimit të shërbyesve civilë sipas konkurseve të shpallura për punësim, duke u përkujdesur që gjatë procedurave të mos cenohet, por të respektohet barazia gjinore, trajtim të barabartë në kontekst të zbatimit të drejtave të njeriut. Gjatë kësaj periudhe kam qenë e ftuar në dy emisione në tv syri dhe 5 emisione në radiot lokale.

*Përkrahja e projekteve të OJQ-ve në promovimin e barazisë gjinore, në mbrojtjen dhe përkrahjen e të drejtave të grave

Bashkëpunimi me OSCE, UHCR, Ceri-në, KFOR-in , etj. lidhur me rastet e dhunës në familje, për pozitën e femrës në familje, në shkollë, shoqëri dhe në përgjithësi;

*.Gjatë kësaj periudhe janë realizuar 6 projekte në fushën e të drejtave të njeriut në fokus të drejtave të grave.

Mban statistikë – bazë të shënimeve dhe i analizon ato nga perspektiva gjinore;

* Këshillimi dhe adresimi i rasteve të dhunës në familje (në mbrojtjen dhe përkrahjen e të drejtave të grave, në kërkim të drejtave të tyre..

Gjatë kësaj periudhe kam adresuar për në Shtëpinë e Sigurt 6 raste për strehim të dhunës në familje..

Si ZBGJ kam mbledhur në komunën e Gjakovës 230 nënshkrime për peticion për zgjatje të pushimit të lehonisë.

*Takim i rregullt me Agjencionin për Barazi Gjinore-Prishtinë, MAPL-DNJ, etj.
Mbledhja e të dhënave të rasteve të dhunës në familje në Shërbimin Policor të Gjakovës dhe në Shtëpinë e Sigurt, QPS, Gjykata, dhe OJQ-të që merren me rastet e dhunës në familje.

Gjatë kësaj kohe Zyrtari për të Drejtat e Fëmijëve ka zhvilluar kontakte me koordinatore të drejtat e fëmijëve, punëtorë të shkollave fillore të Komunës së Gjakovës, rreth promovimit të NJDNJ.

Në bashkëpunim me OSBE-në u mbajt një punëtori ku u diskutua rreth problemit të braktisjes së shkollave si dhe fenomenit të lypjes tek fëmijët.

Me rastin e 1 Qershorit ditës ndërkombëtare të drejtave të fëmijëve u mbajt një manifestim kulturor-artistik i titulluar “Fëmijët në skenë” ku fëmijët shfaqen program të ndryshëm kulturor.

Në bashkëpunim me organizatën e CBDC u mbajt takim pune me temë: Policia dhe kodi i mirësjelljes me qytetar – fëmijë.

- Takime me organizata ndërkombëtare dhe vendore mbi 20. (ato koordinatave PZH e tj.)

- Janë nxjerr mbi 30 certifikata për rregullimin e dokumentacioneve të Ndryshme (as.soc.etj.)
- Me vonës janë regjistruar 8 fëmijë.
- Ne seminare kamë marr pjesë 9 herë.
- Janë djeg 3 shtëpi minoritare.
- Dhunë në familje një grua nga Mali i zi se bashku me 3 fëmijët e vet është paraqitur ne

Zyre ku është përcjellur në shtëpinë e sigurisë ku Ju është rregulluar dokumenti i ID (leja e njoftimit kurse fëmijë i ka lind në Malë të Zi.

Sektori: Shërbimi i Kuvendit Komunal

PRIORITETET

Mbajtja e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, Komitetit për Politikë dhe Financa, Komitetit për Komunitete, Komitetit për Auditim, Komisionit i cili do të hartojë Rregulloren Komunale që ka të bëjë me organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane dhe Komisioni për identifikimin e banesave, dhënien në shfrytëzim të banesave në ndërtesën për banim social,

-Pranimi i shkresave të ndryshme nga qytetarët drejtuar Kryesueses për Kuvendin e Komunës, Komitetin për Politik dhe Financa.

Aktivitetet e planifikuara

Gjatë periudhës janar – dhjetor në zyrën e shërbimit profesional janë pranuar gjithsejtë 130 lëndë, ku prej tyre 109 të miratuara, 7 i'u janë përcjellur drejtorive përkatëse për shqyrtim të mëtutjeshëm, ndërsa të tjerat janë në procedurë.

- janë mbajtur 7 mbledhje të Komitetit për Politik dhe Financa ku janë punuar: 7 procesverbale dhe 19 përfundime;
- janë mbajtur 10 mbledhje të Kuvendit të Komunës ku janë punuar: 10 procesverbale dhe 33 vendime;
- janë mbajtur 5 mbledhje të Komitetit për Komunitete ku janë punuar: 5 procesverbale dhe 1 përfundim;
- janë mbajtur 5 mbledhje të Komitetit për Auditim ku janë punuar: 5 procesverbale dhe janë nxjerrë 3 përfundime;

- janë mbajtur 3 mbledhje të Komisionit për hartimin e Rregullores Komunale që ka të bëjë me organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane ku janë punuar 2 procesverbale dhe janë nxjerrë 2 përfundime;
- janë mbajtur 3 mbledhje të Komisionit për identifikimin e banesave, dhënien në shfrytëzim të banesave në ndërtesën për banim social ku janë punuar 3 procesverbale dhe janë nxjerrë 5 përfundime
- është mbajtur takimi me komunitetin egjiptian, rom dhe ashkali ku është punuar procesverbali;
- Me dt: 26 mars 2010 është mbajtur takimi Java e Kuvendit me Kryetarin e Kuvendit të Kosovës, z. Jakup Krasniqi dhe anëtarët e Kryesisë së Kuvendit ku i pranishëm ishte edhe Kryetari i Komunës, Dr. Pal Lekaj.
- Është mbajtur takimi i parë publik me qytetarë me dt. 28.06.2010
- Gjatë kësaj periudhe në Kuvend janë miratuar 2 Rregullore Komunale: Tatimi në Pronë dhe Rregullorja për Organizimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane të Komunës së Gjakovës.

Afatet

Sipas afateve Ligjore

Resurset

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, ZKK-ja, Drejtoria për Arsim, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë Shqyrtimet e kërkesave të ndryshme nga qytetarët etj.

2. SHËRBIMI CIVIL

Shërbimi civil i Komunës së Gjakovës numëron 256 të punësuar. Të gjithë trajtohen në pajtim me dispozitat e Rregullores për Organizimin e Shërbimit Civil. Të gjithë shërbyesit civilë janë të pajisur me kontrata të punës, puna e të cilëve bazohet në aftësitë, arsimimin dhe përvojën e fituar, duke mohuar çdo ngjyrim politik apo partiak në punën e tyre, me qëllim që ky shërbim të aftësohet dhe të përgatitet profesionalisht për t'u përballur me të gjitha sfidat gjatë rrugëtimit tonë drejt përmbushjes së standardeve moderne dhe bashkëkohore.

Të përkushtuar për respektimin dhe aplikimin e ligjshmërisë, askush jashtë normave ligjore nuk mund të pranohet, as të largohet nga puna. Në këtë kontekst:

- janë shpallur konkurset për këto pozita:

a) Udhëheqës i Zyrës Komunale për Komunitete.....	1 pozitë
b) Motër – teknik medicinal i komunitetit për QMF - Skivjan	1 pozitë
c) Zyrtar për Arsimin e Mesëm të Ulët.....	1 pozitë
d) Zyrtar për kthim.....	1 pozitë
e) Inspektor Komunal.....	2 pozita
f) Për drejtor dhe zëvendës drejtor janë publikuar konkurse për 23 shkolla të mesme dhe fillore të komunës sonë,	
g) Për drejtor është publikuar konkursi për 15 shkolla fillore të komunës sonë,	
h) Bashkëpunëtor Profesional për Zhvillimin Rural.....	1 pozitë
i) Udhëheqës i Sektorit të Shëndetit Primar.....	1 pozitë
j) Drejtori i Teatrit Profesional.....	1 pozitë
k) Bibliotekist-e në Bibliotekën e qytetit “Ibrahim Rugova”.....	1 pozitë

Kontratat e punës për të gjithë shërbyesit civilë janë përpiluar dhe vazhduar në kohëzgjatje prej një (1) viti.

Sipas kërkesave të punëtorëve janë lëshuar vërtetime të punës, vendime të pushimeve vjetore, mjekësore, pushime pa pagesë si dhe janë mbajtur evidencat për funksionimin sa më efikas të shërbimit civil komunal.

Me poshtë në formë tabelore është i pasqyruar shërbimi civil i administratës komunale, arsimit dhe shëndetësisë.

Të punësuarit në administratë

Struktura kualifikuese				Struktura etnike				Struktura gjinore	
super.	e lartë	Shk. e mesme	Shk. fillore	shqiptar	serbë	turq	të tjerë	m	f
80	43	132	1	251	-	-	4	178	78

Të punësuarit në arsim

Struktura kualifikuese				Struktura etnike				Struktura gjinore	
super.	e lartë	Shk. e mesme	Shk. fillore	shqiptar	serbë	turq	të tjerë	m	f
552	650	244	144	1544	-	-	-	755	835

Të punësuarit në shëndetësi

Struktura kualifikuese				Struktura etnike				Struktura gjinore	
super.	e lartë	Shk. e mesme	Shk. fillor.	shqiptar	serbë	turq	të tjerë	m	f
130	6	239	3	374	-	-	3	110	268

Raporti vjetor (01.01.2010-24.12.2010)

3. ZYRA LIGJORE

PRIORITETET

Punimi i të gjitha akteve administrative të cilat janë të lidhura me përfundimet e miratuara në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve, punimi i vendimeve të Kryetarit të Komunës, si dhe punë të tjera të lëmesë juridike .

Aktivitetet

Janë punuar: 43 procesverbale të BD, 1 procesverbal i Këshillit për Siguri në Bashkësi, 161 përfundime, 161 vendime, 131 akte të ndryshme, (aktpërcjellës, autorizime, njoftime, komente të mar. mirëkuptimi etj.), është ofruar konsulentë për organet e administratës komunale

Afatet

Janë respektuar afatet ligjore

4. ZYRA PËR INFORMIM

PRIORITET

Zyra për Informim, gjatë vitit 2010, është fokusuar kryesisht në prezantimin e aktivitetit gjithëpërfshirës dhe transparencës së të gjitha sektorëve përbrenda Kuvendit Komunal, duke qenë aktual dhe me interes për opinionin e gjerë. Në këtë periudhë aktiviteti i Zyrës për Informim Publik ka lutur një rol të veçantë në disa fusha të hapësirës së informimit dhe të veprimt, si përcjellja e punimeve të Asamblesë Komunale, publikimi i takimeve me interes për opinionin të kryetarit të Komunës, kryesuesve të KK-së drejtorive, si dhe sektorëve brenda administratës civile. Pasimi në Web faqe i të gjitha informacioneve, njoftimet dhe shpalljet publike për opinion dhe për Kuvendin Komunal. Një transparencë e veçantë dhe

me kohë për njoftimin e përfaqësuesve të mediave elektronike dhe të shkruara për të gjitha ngjarjet dhe takimet ditore të kreut komunal dhe aktiviteteve brenda drejtorive përkatëse. Kontakti me qytetarë përmes Web Faqes për sensibilizimin e masës për kryerjen e obligimeve ndaj KK-së. Implementimin e projektit “Mos Drogës” bashkërisht me EULOG-un si sukses i Zyrës për Informim, që ka pas edhe fjalë miradije EULOGU. Suksesi i mirëfilltë i arritur për transparencë dhe pasurimin e Web faqes me profesionalizëm të veçantë në lëmin e informimit të shpejtë me informacione bazuar me projektin e Bashkësisë Evropiane për komunat e Kosovës “Transparenca Komunale”, ka marr mirënjohje për transparencë, dhe kjo për freskimi të Web Faqes me lajme kryesore, njoftime dhe shpallje publike të përditshme. Web faqja e KK-së së Gjakovës, në këtë vit, është radhit në kreun e listës së komunave të Kosovës. Puna e Zyrës për Informim Publik e bërë gjatë vitit 2010 është produkt i ynë por që bazohet edhe nga aktiviteti i drejtorive dhe njoftimet dhe informimet e tyre me kohë. Informacione dhe njoftime të prezantuara në Web Faqe, kanë të bëjë me punën dhe aktivitetin e kryetarit të komunës, Dr. Pal Lekaj, drejtorive. Sa i përket drejtorive do cekur se të gjitha ishin të prezantuara në vazhdimësi.

Aktivitetet e realizuara

- I. Publikimi i njoftimeve a.- 180
- II. Shpalljet Publike b. 152
- III. Përcjellja e takimeve zyrtare të Kryetarit b. 391
- IV. Përcjellja e takimeve zyrtare të drejtorëve a. 129
- V. Përcjellja e takimeve zyrtare të kryesuesve të KK-së a. 16
- VI. Përcjellja e takimeve të Komisioneve të Asamblesë Komunale a. 8
- VII. Njoftime për media a. 343
- VIII. Hapja e Web Faqes nga publiku a. 17623
- IX. Kërkesat e qytetarëve përmes Web Faqes a. 190
- X. Përcjellja e aktivitetit të Zyrës për Barazi Gjinore dhe për Komunitete

Aktivitetet e planifikuara

- I. Publikimi i njoftimeve
- II. Shpalljet Publike
- III. Përcjellja e takimeve zyrtare të Kryetarit
- IV. Përcjellja e takimeve zyrtare të Drejtorit të Administratës dhe Personelit
- V. Përcjellja e takimeve zyrtare të dy Zëvendës kryesuesve të KK-së
- VI. Përcjellja e takimeve të Komisioneve të Asamblesë Komunale
- VIII. Njoftime për media
- IX. Hapja e Web Faqes nga publiku
- X. Kërkesat e qytetarëve përmes Web Faqes
- XI. Anketa me qytetarë për punën e KK-së
- XII. Përcjellja e aktivitetit të Zyrës për Barazi Gjinore dhe për Komunitete

Afatet Resurset

Ditore-të gjitha sektorët

Aktivitetet e realizuara

Publikimi i njoftimeve a.- 218, Shpalljet Publike a. 162, Përcjellja e takimeve zyrtare të Kryetarit e tjera a.145, Përcjellja e takimeve zyrtare të drejtorëve a. 80, Përcjellja e takimeve zyrtare të kryesuesve të KK-së a. 14, Përcjellja e takimeve të Komisioneve të Asamblesë Komunale a. 14 Njoftime për media a. 343 , Hapja e Web Faqes nga publiku a. 15.943 , Kërkesat e qytetarëve përmes Web Faqes a. 79

5. ZYRA E PROKURIMIT

Janë kryer këta tenderë:

JANË KRYER KËTA TENDERË:

- 1."Menaxhimi i byfes në KK Gjakovë" - kontrata nr.001 është nënshkruar me dt.01.03.2010;
- 2."Kremtimi i Ditës së Pavarësisë së Kosovës" - kontrata nr.002 është nënshkruar me dt.12.02.2010;
- 3."Menaxhimi i parkingjeve në rrugët "N.Terezë " dhe "M.Barleti" - kontrata nr.003 është nënshkruar me dt. 26.04.2010;
- 4."Furnizimi dhe mirëmbajtja e ndriçimit publik" - kontrata nr.005 është nënshkruar me dt.23.04.2010;
- 5."Riparimi i aparateve fotokopjuese" - kontrata nr.007 është nënshkruar me dt.18.03.2010;
- 6."Furnizim me dru në disa shkolla" - kontrata nr.008 është nënshkruar me dt.18.03.2010;
- 7."Mirëmbajtja verore e rrugëve urbane" - kontrata nr.009 është nënshkruar me dt.16.04.2010;
- 8."Ndërrimi i dyerve në disa shkolla" - kontrata nr.010 është nënshkruar me dt.19.03.2010;
- 9."Lyerja e tri urave" - kontrata nr.011 është nënshkruar me dt.19.03.2010;
10. "Hartimi-përpilimi i projekteve ideore dhe kryesore dhe mbikëqyerja profesionale gjatë realizimit " - kontrata nr.012, është nënshkruar me dt.11.08.2010;
- 11."Menaxhimi i tregut "Livadhi i Taphaneve" - kontrata nr.013 është nënshkruar me dt.16.04.2010;
- 12."Menaxhimi i tregut "Ish Kazerma e APJ-së" - kontrata nr.014 është nënshkruar me dt.12.04.2010;
- 13."Ndërtimi-Riparimi i rrjetit të kanalizimit të ujrave të zeza atmosferike dhe ujësjellësit" - kontrata nr.015, është nënshkruar me dt.05.05.2010;
14. "Furnizim me GPS" - kontrata nr.016 , është nënshkruar me dt.08.09.2010;
- 15."Mirëmbajtja e objekteve –QKMF – së,QMF-ve,punkteve shëndetësore si dhe QPS " - kontrata nr.017 është nënshkruar me dt. 13.05.2010;
- 16."Furnizim me material ushqimor dhe higjenik për nevojat e KK Gjakovë" - kontrata nr.018 është nënshkruar me dt. 21.06.2010;
- 17."Furnizim me klima" - kontrata nr.019 është nënshkruar me dt.07.06.2010;
- 18."Furnizim me inventar" - kontrata nr.020 është nënshkruar me dt. 19.04.2010;
- 19."Ndërtimi i QMF-së "Emin Duraku" në Gjakovë" - kontrata nr.021 është nënshkruar me dt.27.05.2010;
- 20."Furnizim me material hargjues për laboratorin biokimik hematologjik në QKMF" – kontrata nr.022 , është nënshkruar me dt.25.10.2010;
- 21."Furnizim me material hargjues për laboratorin e stomatologjisë në QKMF" - kontrata nr.023 është nënshkruar me dt. 05.05.2010;
- 22."Furnizimi dhe montimi me perde trakë dhe veneciane" - kontrata nr.025 është nënshkruar me dt.11.05.2010;
- 23."Ndërtimi – asfaltimi i rrugës Ferma e shpezëve – Rezinë " - kontrata nr.026 është nënshkruar me dt. 21.06.2010;
- 24."Furnizim me topa dhe kupa për mbajtjen e garave komunale" - kontrata nr.027 është nënshkruar me dt. 07.06.2010;
- 25."Furnizim me material shpenzues administrativ për nevojat e KK në Gjakovë" - kontrata nr.028, është nënshkruar me dt. 15.06.2010;
- 26."Riparimi i sistemeve të ngrohjes në disa shkolla" - kontrata nr.030 është nënshkruar me dt. 17.05.2010;
- 27."Renovimi i objekteve të KK dhe në disa shkolla" - kontrata nr.031 është nënshkruar me dt. 07.06.2010;
- 28."Renovimi i sh.m.t."Nexhmedin Nixha" - kontrata nr.033 është nënshkruar me dt. 15.06.2010;
29. "Shërbime emergjente" – kontrata nr.035, është nënshkruar me dt.20.09.2010;
- 30."Furnizim me kompjutera,printerat dhe aparat fotokopjues" - kontrata nr.036 është nënshkruar me dt. 31.05.2010;
- 31."Furnizim me karrika" - kontrata nr.037 është nënshkruar me dt. 31.05.2010;
- 32."Furnizim me inventar për zyret e KK Gjakovë" - kontrata nr.039 është nënshkruar me dt. 07.06.2010;

33. "Ndërtimi i kanaleve për ujitje në zonat rurale"-kontrata nr.040, është nënshkruar me dt.02.07.2010;

34. "Rregullimi i rrjedhjes së lumit Erenik për mbrojtjen e pendës në fshatrat Babaj bokës dhe Smolicë nga erozioni" - kontrata nr.041, është nënshkruar me dt.07.07.2010;

35. "Ndërtimi i pendës për ujitje në fshatin Rracaj" - kontrata nr.042, është nënshkruar me dt.22.07.2010;

36. "Ndërtimi i urës automobilistike në segmentin e rrugës "Sadik Stavileci" në Gjakovë" - kontrata nr.044, është nënshkruar me dt.12.07.2010;

37. "Sigurimi fizik i objekteve të KK Gjakovë" - kontrata nr.046, është nënshkruar me dt.02.08.2010;

38. "Furnizim me shenja të komunikacionit, vendosja e sinjalizimit horizontal, vertikal dhe semaforëve" - nr.046/a(pj.I,II,III), është nënshkruar me dt.19.10.2010;

39. "Menaxhimi i tregut "Orize"" - kontrata nr.047, është nënshkruar me dt.11.08.2010;

40. "Mirëmbajtja e objekteve të KK Gjakovë" - kontrata nr.047/a, është lidhur me dt.02.08.2010;

41. "Sigurimi dhe montimi i dyerve në disa shkolla" - kontrata nr.048, është nënshkruar me dt.22.07.2010;

42. "Renovimi i dysHEMEVE në disa shkolla" - kontrata nr.049, është nënshkruar me dt.29.07.2010;

43. "Rrethimet e oborreve në disa shkolla" - kontrata nr.050, është nënshkruar me dt.26.07.2010;

44. "Furnizim me dru për ngrohje(bungu) dhe sharritja e tyre për nevojat e vijave buxhetore të KK Gjakovë"-kontrata nr.051, kontrata është nënshkruar me dt.02.08.2010;

45. "Ndërtimi –shtruarja me kubëza betoni e rrugëve dhe trotuareve-kontrata nr.052, është nënshkruar me dt.23.09.2010;

46. "Renovime të ndryshme në objekte të KK Gjakovë" – kontrata nr.053, është lidhur me dt.30.09.2010;

47. "Furnizim me medikamente mjekësore " -kontrata nr. 054, është nënshkruar me dt.05.11.2010;

48. "Furnizim me material për molerimin e objekteve shkollore në Komunën e Gjakovës " – kontrata nr.055, është nënshkruar me dt.20.09.2010;

49. "Bartja e nxënësve në relacione të ndryshme"-kontrata nr.056, është nënshkruar me dt. 11.10.2010;

50. "Renovimi dhe lyerja e parketit në sh.f. "Mazllom Këpuska"-kontrata nr.057, është nënshkruar me dt.23.08.2010;

51. "Furnizim me naftë për ngrohje" –kontrata nr.058, është nënshkruar me dt.04.10.2010;

52. "Renovimi i ndriçimit publik në qytetin e Gjakovës me poqa elektrik"- kontrata nr.059, është nënshkruar me dt.10.11.2010;

53. "Ndërtimi i urës për këmbësorë mbi lumin Krena në rr. "Dëshmorët e Lirisë" (lagjia e Spitalit) në Gjakovë " - kontrata nr.060, është nënshkruar me dt.22.11.2010;

54. "Ndërtimi-asfaltimi i rrugës lokale Madanaj-Rripaj" – kontrata nr.061, është lidhur me dt.02.11.2010;

55. "Mirëmbajtja dimërore e rrugëve urbane dhe rurale" – kontrata nr.062, është lidhur me dt.04.11.2010;

56. "Furnizimi, mbushja dhe kontrollimi i aparateve kundër zjarrit" –kontrata nr.063, është nënshkruar me dt.07.10.2010;

57. "Furnizim vjetor me derivate të naftës për nevojat e KK Gjakovë"- kontrata nr.066, është lidhur me dt.01.12.2010;

58. "Sanimi i rrugëve të asfaltuara në Komunën e Gjakovës" –kontrata nr. 067, është lidhur me dt.20.12.2010;

59. "Dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi në institucionet parashkollore" - kontrata nr.068, është nënshkruar me dt.19.10.2010;

60. "Transporti vjetor i arsimtarëve dhe nxënësve"-kontrata nr.069, është nënshkruar me dt.19.10.2010;
61. "Ndërtimi-asfaltimi i rrugës në fshatin Brovinë " – kontrata nr.071,është nënshkruar me dt.19.11.2010;
62. "Furnizim me mish dhe prodhime të mishit"- kontrata nr.073 , është lidhur me dt.22.11.2010;
63. "Sanimi i rrugëve me zhavor"- kontrata nr.074, është nënshkruar me dt.03.11.2010;
64. "Ndërtimi-asfaltimi i rrugës në fsh.Moglicë" – kontrata nr.077,është nënshkruar me dt.23.11.2010;
65. "Furnizim me automjete për nevojat e D.Urbanizmit dhe D.Shëndetësisë " – kontrata nr.078,është nënshkruar me dt. 18.11.2010;
66. "Riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve zyrtare për nevojat e KK Gjakovë" – kontrata nr. 079, është lidhur me dt.01.12.2010;
67. "Rregullimi dhe mirëmbajtja e gjeneratorit " – kontrata nr.80, është nënshkruar me dt. 12.11.2010;
68. "Menaxhimi i parkingut përballë Kuvendit Komunal" – kontrata nr.81, është nënshkruar me dt.09.12.2010;
69. "Menaxhimi i parkingjeve në rrugët "N.Terezë" dhe "M.Barleti" – kontrata nr.083, është nënshkruar me dt.09.12.2010;
70. "Furnizim me mobile" –kontrata nr.082, është nënshkruar me dt.19.11.2010;
71. "Sigurimi dhe montimi i kamerave në shkollat "H.Dushi" dhe "H.Zajmi"" – kontrata nr. 085,është nënshkruar me dt.20.12.2010;
72. "Furnizim me pajisje elektronike" – kontrata nr.088,është nënshkruar me dt.20.12.2010;

NË PROCEDURË JANË KËTA TENDERË :

1. "Furnizim me shenja të komunikacionit,vendosja e sinjalizimit horizontal,vertikal dhe semaforëve" - nr.046/a (PJ.iv);
2. "Mirëmbajtja e gjelbërimit të qytetit" – nr.076;
3. "Transporti i nxënësve" – nr. 086;
4. "Ndërtimi i rrugës "Dëshmorët e Lirisë" – nr.087;
5. "Furnizim me material të shtypur zyrtarë" – nr.089.

JANË ANULUAR KËTA TENDERË:

1. "Furnizimi dhe montimi me tri TS-160 KVA në fsh.Palabardhë,Hereq dhe Meqe" - nr.004;
2. "Furnizim me një automjet" - nr.006;
3. "Mirëmbajtja e makinave stomatologjike" - nr.024;
4. "Ndërtimi i kompleksit memorial "27Prilli 1999" në Meje" - nr.029;
5. "Mitingu i poezisë Gjakova 2010" - nr.032;
6. "Rrënimi-Ekzekutimi i objekteve të ngritura pa leje-ilegale" - nr.034;
7. "Furnizim me automjete për nevojat e KK Gjakovë" - nr.038;
8. "Manifestimi i "14Qershori-Dita e Çlirimit të Gjakovës"" - nr.043;
9. " Marrja me qera e zyrave për nevojat e KK Gjakovë" - nr.045
10. "Zhvendosja e trafos në fsh.Novosellë e Ulët "- nr.064.
11. "Instalimi i ngrohjes qendrore në QMF-në Ereniku" –nr.065;
12. "Furnizim me farë gruri dhe plehra kimike për mbjelljen vjeshtore 2010" –nr.070;
13. "Furnizim me stufa" –nr.072;
14. "Furnizim me një autoambulancë" – nr.075;
15. "Bartja e automjeteve me merimang" – nr.084.

7. ZYRA E KOMOSACIONIT

Gjatë periudhës raportuese Zyra e Komasaçionit në Drejtorinë e Gjeodezisë, Kadaster dhe e pronës ka dorëzuar 743 lëndë të përfituara të komasaçionit në këto ZK Janoshë; Zhdrellë; Novoselë e Ulët; Trakaniq; Osek Pashë; Rogovë II dhe Marmull. Lidhur me çka konstatojmë se komasaçioni në këto zona është kryer me sukses dhe kadastra pronarët i ka pajisur me certifikata të pronësisë dhe kopje të planit dhe lidhur me këtë konstatojmë se janë kryer gjithsejtë 2.968 dhe mbetet të përfundohet pjesa e mbetur prej 5.800 ha tokë bujqësore.

8. ZYRA KOMUNALE PËR KOMUNITETE - Z K K

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim ju raporton rreth angazhimeve që ka patur gjatë vitit 2010, e që janë si në vijim: në kuadër të bashkëpunimit me Organizatat vendore dhe ato ndërkombëtare janë zhvilluar disa aktivitete ku janë ndihmuar familjet e varfëra dhe familjet e vërshuara me ndihma humanitare ushqimore (miell, vaj, sheqer), 120 pako higjienike, 200 sungjera. Poashtu, në kuadër të asistencës për ri-integrimin e personave të zhvendosur kanë përfutur 5 familje në ndërimin e shtëpive, ku janë ndihmuar poashtu me dru zjarri dhe gjëra ushqimore, 5 multikultivator dhe 2 lopë janë shpërndarë për familjet e të zhvendosurve. Poashtu gjatë vitit, në kuadër të projekteve për stabilizimin e komuniteteve, Mercy Corps ka aprovuar projektin e kanalizimit në Brekoc, kurse IOM ka aprovuar 2 projekte individuale për biznes dhe një për komunitete. Sa i përket riatdhesimit 369 persona janë riatdhesuar në Kosovë.

Bashkëpunimi me Organizatat lokale dhe Ndërkombëtare

ZKK-ja ka bashkëpunim të mirëfillt me organizatat lokale dhe ndërkombëtare të cilat kanë për qëllim zhvillimin dhe integrimin më të mirë të komuniteteve në komunën e Gjakovës. Gjatë vitit kemi patur disa takime dhe bashkëpunim të mirë me organizata vendore dhe ndërkombëtare siç janë: Mercy Corps, IOM, IKS, OSCE, DRC, Caritas, UNMIK, UNHCR, ICO, CRPK, KAAD, KFOR, Kryqi i Kuq i Kosovës si dhe Bethany Christian Service. Në takimet e mbajtura me këto organizata është biseduar për zhvillimin e komuniteteve, të drejtat e tyre, Implementimi i Rregullorës 02/2010 për Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim, Kthimi dhe Ri-integrimi i komuniteteve, ndihma që ipet për personat e zhvendosur nga rajoni, për projektet që kanë të bëjnë lidhur me stabilizimin e komuniteteve (ndërtimi i shtëpive në koloni), projekti i Mercy Corps për zhvillim të Komuniteteve si dhe për projektin e IOM për zgjerim të bizneseve etj. Bashkëpunim të veçantë ku kemi ndihmuar shumë familje kemi me UNHCR-në dhe Kryqin e Kuq të Kosovës.

Projektet e aprovuara për Stabilizim të Komuniteteve

1. Projekti i Mercy Corps i cili ka të bëjë me zhvillimin e komuniteteve. Në kuadër të Projektit për zhvillimin e komuniteteve është arritur që të aprovohet projekt lidhur me ndërtimin e sistemit të kanalizimit të ri për fshatin Brekoc, ku edhe komuna e Gjakovës ka participuar me 25 % të mjeteve. Ky projekt tashmë është realizuar.
2. Organizata për Mirgrim IOM në kuadër të projektit për stabilizim të komuniteteve ka aprovuar tre projekte, ndër të cilat dy projekte individuale për zgjerimin e biznesit dhe një projekt për komunitete. Nga projektet individuale kanë përfutur Besim Deva dhe Kujtim Kurti nga komuniteti egjiptian ku për zgjerimin e bizneseve të tyre janë ndihmuar me blerjen e makinave punuese. Ndërsa nga projekti për komunitete ka përfutur organizata "Bethani Christian Service" për rregullimin dhe dekorimin e oborrit të qendrës së komuniteteve në Brekoc, si dhe blerjen e lodrave për oborrin e qendrës.

Kthimi dhe Riatdhesimi

ZKK së bashku me zyrëtarin për kthim ka pranuar, regjistruar dhe ndihmuar kthimin e personave të zhvendosur nga Kosova në shtetet e rajonit si dhe personat e riatdhesuar. Sa i përket numrit të të kthyerve nga rajoni, gjatë vitit 2010 janë kthyer 4 familje të komunitetit

egjiptian. Ndërsa rreth 20 familje të zhvendosura në Mal të Zi kanë shprehur dëshirën që të kthehen në vendin e tyre në Gjakovë, mirëpo asnjëra nga ato familje nuk posedon tokë dhe kërkojnë nga Komuna e Gjakovës që të ju ndihmojë në këtë aspekt.

- **Deri tani janë ndërtuar 5 shtëpi për familjet e të zhvendosurve nga komuniteti egjiptian, 3 në skivjan dhe 2 në Vraniq.**

Ndërsa sa i përket personave të riatëdhësuar gjatë vitit 2010 janë kthyer:

- 369 persona nga diaspora, ku 235 persona i takojnë komunitetit Shqiptar ndërsa 64 komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, dhe shumica e tyre janë të kthyer me dhunë.
- 1 kontinjer nga Komuna e Gjakovës iu është dhënë për strehim të një personi të kthyer me dhunë nga Franca e që jeton në fshatin shishman.

Nga këto mjete janë kryer 49 lëndë ndërsa katra janë në procedurë .

Shpenzimet e ZKK-së për periudhën Janar – Nëntor – 2010

<i>Buxheti sipas kategorive</i>	<i>Buxheti</i>	<i>Alokimet</i>	<i>Mbetet për tu alukuar</i>	<i>Shpenzimet</i>	<i>Zotimet</i>	<i>Mbetja</i>	<i>%shpenz. me alokime</i>
PAGAT	12,474.00	11,397.00	1,077.00	11,426.42	-	(29.42)	100.26
M & SHËRBIME	12,379.00	12,379.00	-	10,520.48	1,858.52	1,858.52	84.99
DONACION	-	-	-	-	-	-	#DIV/0!
Gjithsej	24,853.00	23,776.00	1,077.00	21,946.90	1,858.52	1,829.10	92.31

2. DREJTORIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT SEKTORI I KULTURËS SEKTORI I KULTURËS

- Manifestimi i 17 Shkurtit- Dita e Pavarësisë së Kosovës, me shumë veprimtari kulturore e sportive
- Shënimi i 27 Prillit – Dita e të zhdukurve – organizuar në Meje
- Shënimi i 14 Majit Dita e Dëshmorëve -përcjellë me shumë veprimtari kulturore e sportive
- Mitingu i Poezisë- 15 maj- i përcjellë me 7 promovime librash në Gjakovë dhe Tropojë
- Pjesëmarrja në Festivalin mbarëkombëtar të këngës qytetare mbajtur në Elbasan
- Festivali teatror përkujtimor”Nura- Bejtullahu- Domi”
- Panairi i shkencës dhe kulturës në bashkëpunim me shkollën fillore “Yll Morina
- Manifestimi i 14 Qershorit- Dita e çlirimit të Gjakovës- përcjellë me shumë veprimtari kulturore
- Shënimi i 100 vjetorit të lindjes së Nënës Terezë- zbulimi i shtatores së saj në Novosellë
- Filmi dokumentar për akademik Pajazit Nushin- skenari e regjia Jahja Shehu
- Festivali mbarëkombëtar i këngës për fëmijë- “Lyra Fest”
- Manifestimi kulturor- rinor –“ Kush është më i miri”me nxënësit e shkollave të mesme
- Gjashtë shfaqje teatrore apo filma dokumentarë të organizuar nga OJQ minoritar ”Prosperiteti”
- Shfaqet pjesa teatrore”Kuzhina e viktimave” Regjia: Zana Hoxha
- Festivalin e XV teatror “Fëmijët në skenë: u shfaqën 13 pjesë teatrore për fëmijë
- Dy promovime të projekteve humoristike” Avash , avash” dhe
- Shënimi i 28 Nëntorit. Veprimt. kulturore kanë filluar nga data 22 - 28 nëntor:(koncerte, promovime, ekspozita)

- 27 nëntor – Akademi përkujtimore kushtuar të kryengritjes së vitit 1910, shënimi 100 vjetorit të rënies së atdhetarëve Shaban Binaku dhe Avdullah Hoxha, zbulimi i pllakës përkujtimore në vendin e rënies së atdhetarëve Shaban Binaku dhe Avdullah Hoxha dhe vënia e kurorave në varret e tyre.
Koncert festiv me rastin e festave të fundvitit.

MUZEU:

18 vizita të nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme, 5 ekspozita faktografike- historike- njëra me mbështetje suedeze dhe një ekspozitë e pikturave, mbledhje e ekspozitash të zejeve të vjetra të qeleshepunuesve, të mbathtarëve dhe jorganxhinjve, hartimi i katërt projekteve nga etnografia dhe e dy projekteve nga arkeologjia, Hapja e ekspozitës së piktorit gjakovar- Gëmbi Xerxa, vizitë pune e një grup zviceran, vizitë pune me një grup prej 20 vetash, gazetarë të gazetës “Standard” nga Shqipëria, vizitën në muze e paraqiti org. “Arteza”, muzeun e vizituan edhe “hendikepet” nga 35 veta nga Prizreni të shoqëruar nga koordinatori Xhevdet Doda. Ekspozite të vogël, projekt i financuar nga chwb-ja. Është kjo një ekspozitë ku marrin pjesë vendet e Ballkanit Perëndimor. Tema është “Dashuri dhe Jetë”, dhe do të paraqitemi me veshjen e Hasit.

BIBLIOTEKA:

Në bibliotekë janë regjistruar 1.828 persona, java e bibliotekës- përcjellë me shumë veprimtari kulturore, 11.756 shërbime me libra, 279 kopje është pajisur biblioteka me libra të rinj, 10 Manifestime letrare në kuadër të Mitingut të poezisë, 11 përrime të librave, java për të Drejtat e Viktimave të Krimit – shoqëruar me program artistik, 28 Manifestime letrare dhe kulturore me nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme të komunës së Gjakovës, 6 Trajnime, ku është trajtuar digjitalizimi i bibliotekës, rëndësia arsimore, shoqërore e kulturore e librit, dhe format më efektive të tij, etj. Mbi 15.000 nxënës, studentë, arsimtarë e punëtorë e kanë frekuentuar bibliotekën, për libra, shtypin ditor, manifestime letrare, arsimore e kulturore.

TEATRI PROFESIONIST: Premiera : “Vdekja dhe vasha” dhe dy repriza. Premiera **“Hamleti në teatrin tonë”**

SEKTORI I RINISË: Janë mbajtur 10 trajnime treditore, organizuar nga GTZ, takim në MKRS me ministrin Lutfi Haziri, themelimi i Qendrës rinore për Rrafshin e Dukagjinit, ku u njoftua nga GTZ-ja se Gjakova është përzgjedhur si projekti pilot i GTZ-së për implementimin e Planit Rinor të Veprimtarisë me zyrtarë të GTZ-së, Bankës Botërore si dhe me zyrën Japoneze rreth mundësive të tyre në përkrahjen e funksionimit dhe fuqizimit të Qendrës Rinore në Gjakovë, pjesëmarrja në punëtorinë treditore në Shqipëri në mes Zyrtarëve Rinor komunal e GTZ, takim i njësitit për të drejtat e njeriut në Pejë, organizimi i Muajit Rinor Kosovar “Gjakova 2010” hapja solemne Qendrës Rinore me ç’rast GTZ-ja zyrtarisht ofroj donacion në shumë prej 5 000 euro për Qendrën Rinore si dhe Departamenti i Rinisë shumë prej 2.500 euro.

SEKTORI I SPORTIT:

Turneu dimëror në futboll të vogël, aksioni “Te gjithë në borë”. Turneu në volejboll. Turneu në basketboll. **Turneu në Shah**. Turneu individual në ping-pong. Turneu ndërkombëtar i femrave në Hendboll- Shqiponja, Prishtina, Kale dhe Nikshiqi. Turneu në futboll të vogël “H. Dushi”, “H. Zajmi”, “GJ. N. Kazazi. Gara në futboll të vogël. Hendboll, volejboli (d), garat republikane në volejboli (v) - Prishtinë dhe basketbolli (d) – Prizren. Turneu individual në pingpong. Turneu ndërkombëtar në hendboll “Bashkim Idriqi”. Kampionati i Kosovës në peshëngritje. Turneu i Kosovës në boks. Turneu në futsall. Turneu në futboll të vogël- “Pavarësia e SHBA”. Kampionati i Kosovës në peshëngritje. Turneu memorial në boks “Xhafer Thaqi”. Turneu i pionierëve dhe pionierëve në hendboll. Garat e Kosovës në peshkim. Turneu i personave me aftësi të kufizuara në Shah. Pingpong dhe Gollball. Turneu i Kosovës në basketboll me karroca. Kampionati i Kosovës dhe mbarëkombëtar në Badibilding. Turneu individual në ping pong. Turneu individual në shah- lokalet e hendikosit. Turneu në volejboll (vajzat dhe djemtë) - Yll Morina. Garat në gollball (hendikosi). Zgjedhja e sportistit të vitit (është paraparë të mbahet në fund të muajit dhjetor).

Të hyrat për periudhën Janar – Nëntor – 2010

REALIZIMI I TE HYRAVE SIPAS DREJTORIVE TE KK GJAKOVË NËNTOR - 2010				
Nr	BURIMET E TË ARDHURAVE	Planifikimi i periudhes Janar-Nëntor - 2010	Realizimi per periudhen Janar-Nëntor 2010	% e realizimit Janar-Nëntor
13	KULTURA	31,000.00	19,816.85	63.93%

Shpenzimet për periudhën Janar – Nëntor – 2010

Buxheti sipas kategorive	Buxheti	Alokimet	Mbetet për tu alukuar	Shpenzimet	Zotimet	Mbetja	%,shpenz. me alokime
PAGAT	91,330.00	83,307.38	8,022.62	81,647.76	-	1,659.62	98.01
M & SHËRBIME	117,187.00	117,187.00	-	136,036.93	211.00	12.16	116.09
KOMUNALI	35,640.00	35,640.00	-	35,631.83	-	8.17	99.98
SUBVENCIONE	11,507.00	11,507.00	-	10,384.00	-	1,123.00	90.24
KAPITALE					11,906.76		#DIV/0!
Gjithsej	255,664.00	247,641.38	8,022.62	263,700.52	12,117.76	2,802.95	106.48

3. DREJTORIA PËR ARSIM

Investimet e kryera ne objektet e poshtshenuar

Lloji I punimeve

1	"Emin.Duraku"	dyer në dhoma mesimi	Gjakovë
2	"Yll Morina"	dyer në klasa , instalimi elektrik	Gjakovë
3	"Fehmi Agani"	dyer në klasa , renovimi i objektit	Gjakovë
4	"Mustafa Bakija"		Gjakovë
5	"Mazllom Këpuska"	kulmi,dyer,molerim, instalimi elektrik	Gjakovë
6	"Zekeria Rexha"	fasada , elektrika ,dyer , dyscheme	Gjakovë
7	"Selman Riza"	nx.qendrore-aneke	Gjakovë
8	"Zef L.Marku"	nyjet sanit, molerim, dyscheme , dyer	Brekoc
9	"Qemajl Bakija"	molerim	Dol
10	"Pjetër Muqaj"	kulmi, molerim	Guskë
11	"Fahri Hoxha"	dyer	B. Bokes
12	"Luigj Gurakuqi"	dyscheme	Korenicë
13	"Ganimete Tërbeshi"	rrethimi I oborrit të shkollës	Ponoshec
14	"Sylejmon Vokshi"	dyer në klasa	Smolicë
15	"Jahë Salihu"	dyer në klasa	Molliq
16	"Bajram Sadriu"	rrethimi i oborrit të shkollës	Berjahë
17	"Ardhmëria"	dyer në klasa	Ramoc
18	"Mark Z.Perkaj"	dyer në klasa ,nx.qendrore,staza, dritare	Sheremet
19	"Gjergj Fishta"	nyjet sanitare	Bishtazhin

20	"Haxhi Hoti"	dyscheme , molerim	Rogovë
21	"Nimon Ferizi"	dritare	Lipovec
22	"7 Shtatori"	dyer , molerim	Gerqinë
23	"Durak Ahmeti"	kulmi, dritare, fasada	Demjan 1
24	"Kongresi Manastirit"	rrethimi i oborrit të shkollës	Demjan 3
26	"Malush Stavileci"	dritare	Goden
27	"Isa Boletini"	objekt i ri	Osek Hylë
28	"Ukshin Miftari"	dyer në klasa	Skivjan
30	"Engjëll Gjoni"	dritaret në dhoma mësimi	N. e Ulët
34	"Vëllazërimi"	dyscheme në dhoma mësimi	Cërmjan
35	"Ferhat Binishi"	dyscheme në dhoma mësimi	Zhabel
36	"Hazir Ramaj"	dyscheme në dhoma mësimi	Kralan
37	"Remzi Pula"	molerim	Doblibare
39	Shk.fillore	molerim	Hereq
41	"Hajdar Dushi"	molerim i klasave , kamera molererim ,dyscheme ,dyer dhe kamera	Gjakovë
42	"Hysni Zajmi"		Gjakovë
43	"Kadri Kusari"	dritare ne dhoma mesimi	Gjakovë
44	"Nexhmedin Nixha"	dyscheme, dyer, molerim	Gjakovë
47	Gjimnazi	rrethimi i oborrit të shkollës	Rogove
48	Gjimnazi	dyer në dhoma mësimi	Ponoshec
50	Qerdhja "G. Terbeshi"	renovim	Gjakovë
51	Konvikti "S. Stavileci"	renovim	Gjakovë

Të hyrat për periudhën Janar – Nëntor – 2010

REALIZIMI I TË HYRAVE SIPAS DREJTORIVE TE KK GJAKOVË NËNTOR - 2010				
Nr	BURIMET E TË ARDHURAVE	Planifikimi i periudhes Janar-Nëntor - 2010	Realizimi per periudhen Janar-Nëntor 2010	% e realizimit Janar-Nëntor
12	ARSIMI	105,200.00	95,565.00	90.84%

Shpenzimet për periudhën Janar – Nëntor – 2010

Buxheti sipas kategorive	Buxheti	Alokimet	Mbetet për tu alukuar	Shpenzimet	Zotimet	Mbetja	%,shpe nz. me alokime
PAGAT	5,002,975.00	4,583,255.66	419,719.34	4,555,487.78	-	27,767.88	99.39
SHËRBIME	522,731.54	499,846.54	22,885.00	412,428.89	83,672.99	3,744.66	82.51
KOMUNALIT	260,000.00	254,500.00	5,500.00	211,137.63	2,881.27	40,481.10	82.96
KAPITALET	261,516.00	237,716.00	23,800.00	219,177.94	18,364.30	173.76	92.20
DONACION							#DIV/0!
Gjithsej	6,047,222.54	5,575,318.20	471,904.34	5,398,232.24	104,918.56	72,167.40	96.82

4. DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Fushë veprimtaria e Drejtorisë komunale për buxhet dhe financa është e bazuar në dispozitat ligjore mbi qeverisjen e Komunave të Republikës së Kosovës, Plan programit të punës të kësaj Drejtorie për vitin fiskal 2010, pastaj të Ligjit Mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, nr

03/L-048. Rregullores Komunale për Tatimin mbi Pronën e Paluajtshme 01. Nr.011-5752/2009 dhe dispozitave tjera përcjellëse të buxhetit dhe financave.

Drejtoria për buxhet dhe financa është përgjegjëse për koordinimin dhe menaxhimin financiar të buxhetit komunal si dhe për zhvillimin dhe zbatimin e politikave fiskale dhe sistemeve administrative, zbatimin e sistemit të kontabilitetit të Thesarit.

I. SEKTORI PËR BUXHET

1. Harmonizimi i Buxhetit komunal të vitit 2010, sipas rekomandimeve të MEF-it, zbritjeve të kategorisë së mallrave dhe shërbimeve nga Grandi i Qeverisë për RTK-në.
2. Përpilimi i Planit të rrjedhjes së parasë së gatshme (cash flow) për vitin 2010, për dy faza të ndërrimeve buxhetore, për të gjitha Drejtoritë (Programet dhe nën-programet buxhetore), dhe dërgimi i tyre në MEF- (Departamentin e thesarit)
3. Rishikimi i Buxhetit Komunal 2010 , për të gjitha Drejtoritë (Programet Buxhetore), konform Ligjit Mbi Financat publike dhe Përgjegjësitë si dhe rekomandimeve nga ana e MEF-it
4. Përpilimi i Planit dhe dinamikës mujore të realizimit të hyrave vetanake buxhetore për të gjitha Drejtoritë të cilat participojnë në krijimin e të hyrave komunale sipas Buxhetit të aprovuar komunal për vitin 2010.
5. Përgatitja e materialeve buxhetore për Draft buxhetit 2011-13, dhe dërgimi i tyre të gjitha Drejtorive, sipas Qarkores Buxhetore nr, 2011/01 për Komuna


II. SEKTORI PËR FINANCA

1. Gjatë kësaj periudhe -Sektori për financa ka bërë pranimin e të gjitha dokumenteve Financiare.
2. Është bërë përgatitja e pasqyrave –Raporteve financiare mbi të hyrat dhe shpenzimet për vitin 2009 – dhe dërgimi pranë MEF-it dhe aprovimi i tij pranë Asamblesë komunale të komunës sonë.
3. Janë përpiluar Raportet financiare për çdo muaj dhe atë në afatin prej 01-15 të muajit vijues për muajin paraprak.
4. Poashtu janë përpiluar edhe Raportet financiare tremujore të të hyrave dhe shpenzimeve për të gjitha Organizatat buxhetore (16) dhe atë pas çdo tremujori.
5. Është bërë regjistrimin analitik dhe sintetik i tërë dokumentacionit financiar si dhe klasifikimin, evidentimin e dokumenteve për çdo ditë pune.
6. Gjatë kësaj periudhe janë bërë edhe barazimet bankare për të gjitha llojet e shpenzimeve (pagat, investimet kapitale, subvencionet, mallrat e shërbimet) të arkës dhe bankare gjithashtu edhe të Hyrave.
7. Është bërë inventarizimi dhe regjistrimi i mjeteve themelore dhe aseteve komunale sipas objekteve dhe drejtorive .
8. Janë regjistruar të gjitha alokimet e gjashtëmujorit të parë 2010 ,nga Grandi i Qeverisë dhe të hyrave vetanake që kanë arritur nga ana e MEF-it dhe atë konform Planit vjetor të rrjedhjes së parasë së gatshme.
9. Në bashkëpunim me Sektorin e Buxhetit është punuar në Rishikimin e Buxhetit komunal 2010.

KUVENDI KOMUNAL GJAKOVË
SHPENZIMET BUXHETORE SIPAS KATEGORIVE EKONOMIKE NE PERIUDHËN (JANAR- NËNTOR) 2010
PASQYRAT E PËRGJITHSHME


K. ek.	Buxheti sipas kategorive	Buxheti	Alokimet	Mbetet për tu alukuar	Shpenzimet	Zotimet	Mbetja	%shpenz. me alokime
	PAGAT	7,485,872.00	6,864,309.01	621,562.99	6,829,836.23	-	34,472.78	99.50
	M & SHËRBIME	1,295,810.04	1,272,925.04	22,885.00	1,121,756.71	147,204.35	3,963.98	88.12
	KOMUNALIT	532,690.00	527,190.00	5,500.00	472,640.79	2,916.54	51,632.67	89.65
	KAPITALET	5,700,554.46	5,217,595.64	482,958.82	4,904,684.68	296,031.00	16,879.96	94.00
	SUBVENCIONET	324,760.14	324,760.14	-	323,547.82	-	1,212.32	
	DONACIONET	146,948.54	146,881.92	66.62	68,919.99	9,481.31	68,480.62	
	Gjithsej	15,486,635.18	14,353,661.75	1,132,973.43	13,721,386.22	455,633.20	176,642.33	95.60

SHPENZIMET BUXHETORE SIPAS KATEGORIVE EKONOMIKE NE PERIUDHËN (JANAR- NËNTOR) 2010



SHPENZIMET PERIODIKE SIPAS BURIMIT

GRANDI QEVERITAR	VETANAKET	DONACIONET
11,507,320.40	2,145,145.83	68,919.99



Vërejtje: Të gjitha Organizatat buxhetore duhet që për çdo muaj ti kushtojnë kujdes zvogëlimit të shpenzimeve nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve dhe sidomos për shpenzimet telefonike (fikse dhe mobile), karburanteve për mjetet motorike, reprezentacionit dhe furnizimeve me material zyrtar të bëhen sipas Udhëzimit komunale mbi Menagjimin e financave dhe të mos kalohen limitet e parapara me Buxhetin për vitin fiskal 2010.

REALIZIMI I TE HYRAVE SIPAS DREJTORIVE TE KK GJAKOVË NENTOR - 2010				
BURIMET E TË ARDHURAVE	Planifikimi - vjetor 2010	Planifikimi i periudhes Janar-Nentor - 2010	Realizimi per periudhen Janar-Nentor 2010	% e realizimit Janar-Nentor
Drejtoria e Urbanizmit	769500	737500	542367.3	73.5
Kompenz.për rregullimin e tokës ndërtimore	716,000.00	685,200.00	484,370.68	70.69
Komp.për shfrytëz.e përkoh.të tok.ndërt.-si kiosqet	1,000.00	1,000.00		-
Taksa komunale për shfrytëzimin e hapsires publ.	14,500.00	13,500.00	33,932.40	251.35
Te hyrat e ndryshme nga urbanizmi	31,000.00	31,000.00	17,740.26	57.23
Qera e BT -es	7,000.00	6,800.00	6,323.96	93
Drejtoria e Sherbimeve Publike	196,500.00	183,000.00	124,946.00	68.28
Denimet nga trafiku	143,500.00	134,300.00	86,400.00	64.33
Denim ne trafik qe percjellen nga MEFI	140,000.00	131,000.00	85,605.00	65.35
Denim ne trafik -sekuestr.automjeteve	3,500.00	3,300.00	795	24.09
Lejet e perkohshme për shfrytëzimin e rrugës	500	500	-	-
Të hyrat nga parkingjet	5,000.00	4,500.00	2,635.00	58.56
Leje për taxi - vijat e autobusëve	3,500.00	3,200.00	4,400.00	137.5
Të hyrat nga tregjet	43,000.00	39,500.00	11,540.00	29.22
Shitja e kerreve	1,000.00	1,000.00	19,971.00	1,997.10
Drejtoria e Inspekcioni	65,000.00	61,300.00	62,782.70	102.42
Denimet nga Inspekcioni - veterina	30,000.00	28,500.00	22,252.70	78.08
Lejet për plotsimin e kushtev.sanit.teknik	25,000.00	23,500.00	25,265.00	107.51
Sherbimi - pije alkoolike	10,000.00	9,300.00	15,265.00	164.14
Drejtoria e Agrokulturës	4,000.00	3,600.00	2,080.00	57.78
Shëndrrimin e tokës bujqës.në jo-bujq.	4,000.00	3,600.00	2,080.00	57.78
Kadastra	151,000.00	142,000.00	133,127.50	93.75
Të hyrat nga shërbimet kadastrale	151,000.00	142,000.00	133,127.50	93.75
Drejtoria e Zhvillimit Ekenomik	157,500.00	146,900.00	128,657.00	87.58
Leje për ushtrimin e veprimtarisë së bizneseve	3,000.00	2,800.00	4,060.00	145
Leje -taksa mbi firmen e bizneseve	141,000.00	131,000.00	115,597.00	88.24
Leje për vazhdimin e orarit të punës	13,500.00	13,100.00	9,000.00	68.7
Administrata e përgjithshme	118,200.00	107,200.00	109,187.50	101.85
Qertifikatat e lindjes,vdekjes etj	45,700.00	40,700.00	37,156.00	91.29
Qertifikatat e kurorizimit	25,300.00	23,300.00	15,284.00	65.6
Qertifikatat tjera	17,000.00	15,500.00	24,984.50	161.19
Vertetime te dok ndryshme,shkresa ankesa	14,200.00	12,800.00	15,732.00	122.91
Taksa administrative te ndryshme	7,000.00	6,300.00	8,293.00	131.63
Prokurimi-Të hyrat nga shpallja e tenderëve	9,000.00	8,600.00	7,738.00	89.98
Drejtoria për B. e Financa	787,906.00	714,706.00	828,488.37	115.92
Qeraja për lokalet e komunës	30,906.00	28,406.00	42,220.80	148.63
Eksplot.resureseve natyrore,	2,000.00	2,000.00	1,232.00	61.6
Tatimi mbi pronën	622,000.00	562,000.00	659,541.57	117.36
Taksa për rexhistrimin e automjeteve	133,000.00	122,300.00	125,494.00	102.61
Drejtoria P. Juridike	2,000.00	1,880.00	3,010.40	160.13
Te hyrat nga gjykata nga denimet ne trafik	147,000.00	135,000.00	66,295.00	49.11
te hyrat nga pyjet			154.82	#DIV/0!
TOTALI I ADMINISTRATES KOMUNALE	2,398,606.00	2,233,086.00	2,001,096.59	89.61
ARSIMI	113,000.00	105,200.00	95,565.00	90.84
KULTURA	31,000.00		19,816.85	#DIV/0!
SHENDETËSIA	52,000.00	47,100.00	52,658.00	111.8
SUB TOTALI I + II + III	2,594,606.00	2,385,386.00	2,169,136.44	90.93
Participimet e qytetarve dhe të hyrat tjera tj.	-	-	96,255.00	#DIV/0!
Totali i te hyrave me donacione	2,594,606.00	2,385,386.00	2,265,391.44	94.97

Të hyrat për periudhën Janar – Nëntor – 2010

REALIZIMI I TE HYRAVE SIPAS DREJTORIVE TE KK GJAKOVË NËNTOR - 2010				
Nr	BURIMET E TË ARDHURAVE	Planifikimi i periudhes Janar-Nëntor - 2010	Realizimi per periudhen Janar-Nëntor 2010	% e realizimit Janar-Nëntor
8	Drejtoria për B. e Financa	714,706.00	828,488.37	115.92%
b	Qeraja për lokalet e komunës	28,406.00	42,220.80	148.63%
c	Ekspluat.resureseve natyrore,	2,000.00	1,232.00	61.60%
d	Tatimi mbi pronën	562,000.00	659,541.57	117.36%
f	Taksa për rrethimin e automjeteve	122,300.00	125,494.00	102.61%

Shpenzimet për periudhën Janar – Nëntor – 2010

K. ek.	Buxheti sipas kategorive	Buxheti	Alokimet	Mbetet për tu alukuar	Shpenzimet	Zotimet	Mbetja	%,shpenz. me alokime
	PAGAT	129,252.00	117,864.80	11,387.20	117,157.57	-	707.23	99.40
	M & SHËRBIME	45,283.00	45,283.00	-	43,965.76	1,315.00	2.24	97.09
	KAPITALE	3,757,030.00	3,446,328.98	310,701.02	3,385,584.37	52,747.39	7,997.22	98.24
	DONACION	98,816.05	98,816.05	-	31,692.65	-	22,963.30	32.07
	Gjithsej	4,030,381.05	3,708,292.83	322,088.22	3,578,400.35	54,062.39	31,669.99	96.50

ZYRA E THESARIT

1. Kompletimi i lendeve për pagesa me kontratat përkatëse për të gjitha Drejtoritë programet Buxhetore) konform Buxhetit të aprovuar komunal.
2. Ka bërë pranimin e mallit nga zyrtari i pranimit të mallit dhe regjistrimi i tyre në sistemin e pagesave Free-Balance.
3. Janë bërë të gjitha regjistrimet e shpenzimeve buxhetore komunale të arritura gjatë kësaj periudhe nga zyrtari i shpenzimeve, duke i përcjellë po ashtu në sistemin Free-Balance.
4. Është bërë aprovimi i të gjitha shpenzimeve buxhetore që kanë qenë konform dispozitave ligjore dhe të kompletuara për të gjitha Drejtoritë nga Zyrtari certifikues (aprovues), si dha janë Monitoruar dhe kontrolluar Raportet e pagesave në Free-balance nga zyrtari i shpenzimeve dhe zyrtari certifikues (aprovues).
5. Po ashtu është bërë përcjellja në vazhdimësi e pagesave të qirave nga zyrtari i pranimit të mallit
6. Është bërë kontimi i lendeve për shpenzimet e realizuara-ekzekutuara.

IV. SEKTORI PER TATIMIN NE PRONË

Sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/29 për tatimin në pronën e paluajtshme në Kosovë, përgjegjësitë komunale janë:

- 1.Menaxhimi i informatave tatimore mbi pronën
- 2.Vlerësimi i pronës
- 3.Përgatitja dhe lëshimi i faturave të tatimit
- 4.Vjelja dhe vjelja e detyruar e tatimit mbi pronën dhe

Gjatë periudhës janar - Nëntor janë anketuar – ri anketuar 700 prona,

5. DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK

SEKTORI PER NDERTIMIN E RRUGEVE LOKALE DHE PROJEKTEVE TJERA KAPITALE

- Punimi - përpilimi i plan-programit të punës për vitin 2010;
- Punimi i raportit vjetor të punës për vitin 2009;
- Përgatitja e dokumentacionit teknik - ofertës për tenderim - kontraktim vjetor, për punimin e projekteve dhe mbikëqyrjen e tyre gjatë realizimit;
- Përgatitja dokumentacionit teknik për tenderim të projektit ndërtimi i urës automobilistike mbi lumin Llukac, në segmentin e Rr. S. Stavileci – Rezinë veriore në Gjakovë;
- Përgatitja dokumentacionit teknik - ofertës për tenderim – kontraktim vjetor të projektit ndërtimi – shtruarja me kubëza betoni e rrugëve dhe trotuareve;
- Menaxhimi i projekteve dhe mbikëqyrja e tyre, përmes firmës kontraktuese Infra plus;
- Punimi i projekteve përmes firmës kontraktuese Infra plus;
 Kanë përfunduar punimet në këto projekte:
 - Ndërtimi – asfaltimi i rrugës Babaj Bokës – Tyrbe Pulaj, Lg = 1.33 km¹;
 - Ndërtimi – asfaltimi i rrugës në fshatin Duzhne, Lg = 1.0 km¹ ;
 - Ndërtimi – asfaltimi i rrugës Molliq – Nivokaz – Dobrosh, me gjatësi Lg. = 3.90 km;
 - Ndërtimi – shtruarja me kubëza betoni e trotuarit dhe degëzimit III (te furra Pashtriku 2) të Rr. Skënderbeu, Rr. Çameria, si dhe parkingut të objektit të Komunës;
 Janë duke u zhvilluar punimet në këto projekte:
 - Ndërtimi – shtruarja me kubëza betoni e trotuareve në Rr. Vashingtoni, te parku i Lirisë, Rr. Skenderbeu të objekti i Policisë, Rr. S. Stavileci, degëzimi i Rr. Nëna Tereze (te Xhamija, përballë zjarr fiksive), etj.;
 - Ndërtimi – asfaltimi i rrugëve në lagjen Brekoc, Rr. Rripe – Jahoc, Rr. Rogovë – Muhadër, Rr. Shishmon i Bokës – Mazrrek, Rr. Gradish – Smaq 2 – Trravë, Rr. Ferma shpezëve – Rezinë, Rr. Rakovinë – Kralan, Rr. Gjakovë – Guskë – Devë, Rr. Botushë – Koshare, ndërtimi i ujësjellësit Rekës Keqe, etj. Ndërkohe do të vazhdojnë edhe projektet e tjera;

SEKTORI PËR ZHVILLIM

1. Është bërë pranimi i të gjitha 1170 (lëndëve) dokumenteve të Drejtorisë, regjistrimin, klasifikimi i tyre dhe evidentimi.
2. Janë lëshuar 85 vërtetime palëve për shtëpi të djegura nga lufta.
3. Janë shpërndarë 4500 vendime të taksës në firmë.
4. Janë pranuar 954 lëndë nga sektori për leje pune (janë kryer të gjitha lendet e pranuar).
5. Janë lëshuar 95 vendime për zgjatje të orarit me kohë prej 19 kohëzgjatje
6. Janë lëshuar 1373 vërtetime e taksës në firmë.
7. Janë lëshuar 11340 fatura për pagesën e taksës për regjistrimin e automjeteve.
8. Janë regjistruar 59 biznese individuale;
9. Janë regjistruar 8 Sh.p.k. me ndryshime
10. Janë shuer 28 biznese individuale;
11. Janë kryer 90 dublime (certifikata të reja) biznese individuale .

SEKTORI PËR EKSPLOATIMIN E RESURSEVE NATYRORE DHE TAKSA NË FIRMË

- ✓ Gjatë kësaj periudhe raportuese është bërë raporti mujor për të hyrat ku të njëjtat janë raportuar pranë drejtorit të drejtorisë
- ✓ Janë lëshuar **134** Certifikata mbi gjendjen ekonomike sipas kërkesave të palëve të ndryshme.
- ✓ Janë shpërndarë 4500 vendime të taksës në firmë
- ✓ Kontrollimi i subjekteve afariste për leje pune si dhe janë lëshuar 850 Procesverbale.

- ✓ Janë gjobitur 6 transportues ilegal të rërës dhe zhavorrit.

6. DREJTORIA E URBANIZMIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT

Gjatë vitit 2010 për zhvillimin e procedurës në zgjidhjen e lëndëve tjera në procedurë, pranë DUMM janë ndërmarrë edhe këto aktivitete:

- Janë mbajtur takime me stafin e DUMM për ndarjen e lëndëve dhe shqyrtimin e lëndëve të kësaj Drejtorie;
- Është menaxhuar procesi i hartimit të Planit Rregullues Urban “Jugu 1”;
- Janë mbajtur konsultimet urbane me komunitetin e zonës së “Jugut 1” gjatë hartimit dhe konceptimit të këtij Plani;
- Është mbajtur shqyrtimi publik i Planit Rregullues Urban “Jugu 1”;
- Është miratuar Plani Rregullues Urban pranë Kuvendit Komunal;
- Është në menaxhim procesi i hartimit të Planit Rregullues Urban “Xheladin Hana”, “Vashingtoni” dhe “Hysni Dobruna”;
- Janë duke u mbajtur konsultimet urbane me komunitetin e zonës “Xheladin Hana”, “Vashingtoni” dhe “Hysni Dobruna” në hartimin dhe konceptimin e këtij Plani;
- Është menaxhuar procesi i hartimit të Planit Rregullues Urban të vendbanimit joformal “Kolonia”;
- Janë mbajtur konsultimet urbane me komunitetin e zonës “Kolonia” gjatë hartimit dhe konceptimit të këtij Plani;
- Është mbajtur shqyrtimi publik i Planit Rregullues Urban “Kolonia”;
- Është miratuar Plani Rregullues Urban pranë Kuvendit Komunal;
- Janë punuar detyrat projektuese për hartimin e Planeve Rregulluese Urbane si;
 1. PRRU “Jugu 2”;
 2. PRRU “Qarshia e Vogël”;
 3. PRRU “Jugu”;
- Janë hartuar propozim Vendimet për punimin e Planeve Rregulluese Urbane pranë Kuvendit Komunal;
- Janë punuar detyrat projektuese për zgjerimin e rrugëve si:
 1. aksi rrugor “Nëna Terezë” – “Pashko Vasa”
 2. aksi rrugor i magjistrales, rruga “Wesley Clark”
- Është përgatitur nxjerrja dhe listimi i projekteve prioritare të planifikuara me Planin Zhvillimor Komunal dhe Urban sipas kërkesës së “Eulog-ut”
- Është në procedurën e përfundimit hartimi i Rregullores për ndërtim;
- Është hartuar Vendimi për kompensimin për rregullimin e tokës ndërtimore në këste në mvarshmëri me vlerën kushtuese;
- Është hartuar “Strategjia për legalizimin e objekteve të banimit individual- shtëpive familjare, objekteve ekonomike – pompave të benzinës dhe objekteve rekreative – pishinave;
- Është identifikuar dhe punuar raporti i objekteve, banesave dhe lokale në pronësi Komunale sipas dokumentacionit të trashëguar nga ish BVI-ja;
- Është përgatitur propozimi i kriterëve për dhënien në shfrytëzim të objekteve, banesave dhe lokaleve në pronësi Komunale;
- Është përgatitur hulumtimi, identifikimi dhe propozimi i lokacioneve për:
 1. Shkollën fillore – donacion i familjes Rizvanolli;
 2. Objekti shëndetësorë –Qendra e Mjekësisë Familjare;
- Është përgatitur në zgjidhje urbanistike të parkingjeve:
 1. Parkingu i Bibliotekës Regjionale dhe
 2. Parkingu i Kuvendit Komunal;

- Është bërë grumbullimi i shënimeve, analiza, shqyrtimi dhe konceptimi i projekt propozimeve të mini blloqeve urbanistike përgjatë rrugëve si:
 1. “Xheladin Hana” dhe “A.Pailad”;
 2. “Musa Zajmi” dhe
 3. “Sadik Stavileci”;
- Është punuar dhënia e komenteve në propozim marrëveshjen në mes të Komunës dhe KRRU “Radoniqi”;
- Janë punuar përgjigjet në kërkesat e ndryshme të Drejtorive Komunale dhe Avokatit Publik;
- Janë nxjerrja të dhënave teknike nga dokumentacioni teknik për linjën hekurudhore Gjakovë Ratkoc;
- Është punar me mediat lokale në informimin rreth aktiviteteve të Drejtorisë;
- Janë plotësuar pyetësorët rreth gjendjes së banimit në Komunën e Gjakovës dhe formularët për raportin vjetor mbi menaxhimin e objekteve të banimit social sipas kërkesës së Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;
- Në procedure është , pjesëmarrja në konceptimin dhe hartimin e Parkut Memorial “Koshare”;
- Pjesëmarrja në puntoritë, seminarët, konferencat e ndryshme të organizuara nga asociacionet si ; USAID, HENDIKOS, REC, EPTISA, si dhe Ministrinë e Qeverisë së Kosovës dhe ;
- Të gjitha detyrat e dalura sipas kërkesës së Kryetarit, Bordit të Drejtorëve dhe Komitetit.
- Pjesëmarrja në seminarin e organizuar nga MEM me temën “Projekti për zhvillimin institucional për zbatimin e Rregullores për kursimin e Energjisë në ndërtesa.—në Prishtinë.
- Mbikëqyrja në Qendrën e Mjekësisë familjare.
- Pjesëmarrja në Grupin punues ndërinstitucional lidhur me hartimin e vendimit final për Mbrojtjen e përkohshme të burimit ujqor sipërfaqësor.
- Seminar 4 Mujor për Planifikim Komunal të Energjisë në Prizren, Mitrovicë, Gjilan, dhe Prishtinë.
- Punëtorja “Rregullat teknike për objektet për nevojat të “PAK”,
- Takimet e stafit të DUMM për hartimin e Rregullores së ndërtimit.
- Procedura për përfundimin e procesit të emërimit të rrugëve dhe punimin e hartës së Gjakovës.
- Rregullat teknike për nevojat e personave me aftësi të kufizuara.
- Mbikëqyrjet e kanalizimit në fshatin Skivjan.
- Nxjerrja e shënimeve –sasive të infrastrukturave nga PRRU ekzistuese si pjesë e Planit të punës.
- Përfundimi i detyrës projektuese për rrugën “Skenderbeu”.

Të hyrat për periudhën Janar –Nëntor 2010

REALIZIMI I TE HYRAVE SIPAS DREJTORIVE TE KK GJAKOVË NËNTOR - 2010				
Nr	BURIMET E TË ARDHURAVE	Planifikimi i periudhes Janar- Nëntor - 2010	Realizimi per periudhen Janar- Nëntor 2010	% e realizimit Janar-Nëntor
1	Drejtoria e Urbanizmit	737,500.00	542,367.30	73.54%
a	Kompenz.për rregullimin e tokës ndërtimore	685,200.00	484,370.68	70.69%
b	Komp.për shfrytz.e përkoh.të tok.ndërt.-si kiosqet	1,000.00	-	0.00%
c	Taksa komunale për shfrytzimin e hapsires publ.	13,500.00	33,932.40	251.35%
d	Te hyrat e ndryshme nga urbanizmi	31,000.00	17,740.26	57.23%
e	Qera e BT -es	6,800.00	6,323.96	93.00%

Shpenzimet për periudhën Janar –Nëntor 2010

<i>Buxheti sipas kategorive</i>	<i>Buxheti</i>	<i>Alokimet</i>	<i>Mbetet për tu alukuar</i>	<i>Shpenzimet</i>	<i>Zotimet</i>	<i>Mbetja</i>	<i>%,shpenz. me alokime</i>
PAGAT	48,378.00	44,165.00	4,213.00	43,696.03	-	468.97	98.94
M & SHËRBIME	16,379.00	16,379.00	-	15,017.92	1,343.00	18.08	91.69
KOMUNALIT	6,000.00	6,000.00	-	5,309.54	-	690.46	88.49
KAPITALET	115,000.00	111,050.00	3,950.00	31,037.39	80,000.00	12.61	27.95
Gjithsej	185,757.00	177,594.00	8,163.00	95,060.88	81,343.00	1,190.12	53.53

7. DREJTORIA PËR BUJQËSI

Gjatë kësaj periudhe Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka qenë e angazhuar në këto aktivitete:

1. Ndërtimi i kanaleve të ujitjes

Këtë vit janë ndërtuar 2 Penda për ujitje, 1 Pendë me Ministrinë e Bujqësisë në fshatin Sheremet dhe 1 Pendë në fshatin Ramoc nga Kuvendi Komunal – Gjakovë. Po ashtu janë ndërtuar 5 km kanale të ujitjes në 12 fshatra me investime të Komunës dhe do të ujiten mbi 1500 ha tokë që me vite nuk janë ujitur.

2. Organizimi dhe grumbullimi i ndihmave humanitare

Me rastin e vërshimeve në Shkodër, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në muajin Shkurt ka dërguar ndihma humanitare për zonat e rrezikuara nga vërshimet në Republikën e Shqipërisë – Në Qarkun e Shkodrës. Duke marrë parasysh se nevojat për ndihmë kanë qenë për ushqim për bagëti – sanë, janë mbledhur mbi 3000 ballo – sanë për bagëti dhe me 6 mauna - Kamionë janë dërguar në Shkodër.

Po ashtu në muajin Dhjetor janë grumbulluar dhe dërguar edhe 2000 ballo sanë për bagëti për Qarkun e Shkodrës me rastin e vërshimeve që u përsëriten në muajin nëntor.

3. Subvencionimi i fermerëve

Në bashkëpunim me MBPZHR është bërë monitorimi i shpërndarjes së subvencionimit të fermerëve që posedojnë dele, dhi, dhe lopë qumështore, nga ky projekt kanë përfituar 304 fermerë që posedojnë lopë qumështore, 45 që posedojnë dele dhe 12 që posedojnë për dhi. Sasia e mjeteve të përfituara ende nuk është caktuar nga Ministria e Bujqësisë dhe pritet që kjo të ndodh gjatë muajit Korrik.

Kfori Hungarez gjatë muajit Qershor, Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural i ka dhuruar një sasi të ndihmave për sektorin e Bujqësisë e cila konsiston prej 30 makinave mjelëse, 30 bidonëve për bartjen e qumështit, 150 thasë koncentrat për lopë qumështore dhe 300 ballë sanë – ushqim për bagëti. Ky subvencion është shpërndarë në bazë të listës së propozuar të OJQ – Dushkaja - Bec që veprojnë në territorin e Komunës së Gjakovës. Kjo ndihmë 30 fermerëve ju ka mundësuar që të kenë kushte më të mira për mbajtjen e bagëtisë, për higjienën në Stalla etj.

4. Organizimi i trajnimeve për fermerë

Gjatë kësaj periudhe janë organizuar 3 trajnime për fermerë me shoqata të fermerëve nga ana e stafit të Drejtorisë për blegtori lidhur me të ushqyerit e lopëve qumështore, pastaj trajnime dhe dhënie të këshillave profesionale në lëmin e pemëtarisë – format e krasitjes në bashkëpunim me Shoqatën e Pemëtarëve.

5. Programi i mbjelljeve pranverore.

Në pranverë janë mbjellur këto kultura bujqësore: misër 4875 ha, elb 140 ha, tërshërë 120 ha, bimë foraxhere 140 ha, patate 80 ha, fasule monokulturë 10 ha, perime 900 ha dhe të tjera 10 ha. Gjithsejtë 6340 ha. Gjendja e këtyre kulturave të mbjellura është e mirë dhe mund të priten rendimente të kënaqshme këtë vit, duke u bazuar në kushtet klimatike.

Në këtë vit Komuna ka bërë subvencionimin e 750 fermerëve ku është mundësuar rritja e sipërfaqes me kulturë misri. Çdo fermer ka përfituar sasi të nevojshëm të farës së misrit dhe plehut artificial e cila mundëson mbjelljen e 0,5 ha për fermer. Me këtë subvencionim është realizuar mbjellja e 375 ha më tepër me kulturën e misrit.

6. Panairit i Gjedit “Kosova 2010”.

Në bashkëpunim me MBPZHR me 12.06.2010 në fshatin Korenicë - Butsina e Begut është organizuar dhe mbajtur Panairi i Gjedit “Kosova 2010”, ku kanë marrë pjesë rreth 250 fermer me më se 110 gjedhe nga tërë Kosova me 7 raca të gjedheve. Në këtë panair janë përfaqësuar këto raca Hollshtajn, Red Holshtajn, Simental, Braun Swiss, Graunfi, Busha, Kategoria e mëshqerrave dhe kategoria e Demave.

7. Takimet me palë dhe Lëndët

Gjatë kësaj periudhe raportuese në Drejtorinë e Bujqësisë kemi pasur rreth 900 vizita, ku 700 vizita kanë qenë nga fermerët e Komunës sonë. Kurse vizitat tjera kanë qenë takim pune me MBPZHR, Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar (KASH), OJQ “Dushkaja”, OJQ “Heifer”, Kforin Hungarez, Kforin Italian, USAID, Unionin e Fermerëve, Pro.do.cs, etj.

Në aspektin e informimit Drejtoria e Bujqësisë ka qenë prezentë në Emisionin e Bujkut të RTK, në TVSh në emisionin Hapësirë e Blertë, pastaj TV Syri, gazeta ditore ku janë publikuar dhe emituar aktivitetet e Drejtorisë.

Sa i përket lëndëve që janë adresuar në Drejtorinë tonë janë parashtruar rreth 2124 lëndë, prej tyre shumica e këtyre lëndëve janë kërkesa nga palët që kërkojnë ndihmë - subvencione nga Drejtoria për Bujqësi.

8. Dëmet e shkaktuara nga breshëri

Gjatë muajit Korrik ka rënë breshër dhe si pasojë kemi pasur dëme të mëdha në kulturat bujqësore. Pas marrjes së informacioneve, menjëherë zyrtarët e Drejtorisë kanë dalë në terren dhe kanë bërë Vlerësimin e Dëmeve që janë shkaktuar në kulturat e ndryshme bujqësore nga breshëri në 12 fshatrat e Komunës sonë. Sipas raportit të bërë nga komisioni dëmet e shkaktuara nga breshëri janë në vlerë prej 1.000.000 €. Është bërë kërkesë Qeverise për përkrahje por nuk janë përgjigjur.

9. Pyjet

Është bërë bartja e kompetencave nga Ministria e Bujqësisë nëpër Komuna.

Këtë vit janë mbjellur rreth 8 ha përkatësisht me 20000 fidane me pishë të zezë.

10. Fushata e korrje – shirjeve

DBPZHR ka bërë regjistrimin e autokombajnave dhe është bërë takimi me kombajnerët ku janë njoftuar lidhur me rëndësinë e fushatës. Ka qenë i formuar edhe komisioni për kontrollimin e autokombajnave dhe përcjelljen e korrje – shirjeve.

Për korrje - shirje kemi: Gjithsej 4.830 ha, me grurë 4.600 ha, thekna 100 ha, elbi birrës 70 ha, trokal 60 ha. Për fushatën e korrje shirjeve janë angazhuar 62 autokombajna. Rendimenti kete vite ka qene mes 3800- 4000 kg ha

11. Programi i mbjelljeve vjeshtore

Këtë vit Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural ka bërë subvencionimin e fermerëve me farë gruri dhe pleh për mbjelljen e 0.50 ha tokë me këtë kulturë. Nga ky program kanë përfituar rreth 2000 familje ku janë mbjellur 1300 ha me grurë me shume vetëm nga përkrahja e Komunës.

12. Fermeri i Vitit – Darka e Lamës

Si çdo herë edhe këtë vit është mbajtur Fermeri i Vitit – Darka e Lamës i cili organizohet me rastin e vjeljeve të prodhimeve bujqësore. Në këtë manifestim, i cili është bërë tradicional bëhet ndarja e çmimeve për 10 fermerët më të suksesshëm në sektorë të ndryshëm të bujqësisë në Komunës tonë. Janë shpërndarë dhurata modeste për fermerët e vitit. Janë prezantuar shumë shoqata të Komunës sonë me prodhime vendore. Qëllimi i këtij organizimi është mbështetja e fermerëve me të mirë të Komunës, promovimi i shoqatave prodhuese në mënyrë që të arrihet një prodhimtari cilësor dhe sasior. Kanë marrë pjesë mbi 500 pjesëmarrës dhe është bërë prezantimi filmik i aktiviteteve të Drejtorisë së Bujqësisë.

Të hyrat për periudhën Janar –Nëntor 2010

REALIZIMI I TE HYRAVE SIPAS DREJTORIVE TE KK GJAKOVË NËNTOR - 2010				
Nr	BURIMET E TË ARDHURAVE	Planifikimi i periudhes Janar-Nëntor - 2010	Realizimi per periudhen Janar-Nëntor 2010	% e realizimit Janar-Nëntor
4	Drejtoria e Agrokulturës	3,600.00	2,080.00	57.78%
a	Shëndrrimin e tokës bujqë	3,600.00	2,080.00	57.78%

Shpenzimet për periudhën Janar –Nëntor 2010

K. ek.	Buxheti sipas kategorive	Buxheti	Alokimet	Mbetet për tu alukuar	Shpenzimet	Zotimet	Mbetja	%,shpenz. me alokime
	PAGAT	33,108.00	29,380.00	3,728.00	28,464.71	-	915.29	96.88
	M & SHËRBIME	22,379.00	22,379.00	-	16,965.18	5,413.26	0.56	75.81
	SUBVENCIONE	50,000.00	50,000.00	-	49,950.60	-	49.40	
	KAPITALE	305,625.00	268,260.70	37,364.30	231,083.55	37,108.89	68.26	86.14
	Gjithsej	411,112.00	370,019.70	41,092.30	326,464.04	42,522.15	1,033.51	88.23

8. DREJTORIA PËR GJEODEZI KADASTER DHE PRONË

Gjatë periudhës raportuese respektivisht gjysmë vjetorit të parë, duke filluar nga Muaji Janar e gjer në muajin Nëntor, përfundimisht me datën e paraqitjes e këtij Raporti, Sektorit për pronë, në kuadër të Drejtorisë për gjeodezi, kadaster dhe pronë të komunës së Gjakovës, janë ushtruar gjithsejtë :

- Janë lëshuar 6106 fletëposedime
- Janë lëshuar 713 kopje plani
- Janë lëshuar 1408 certifika
- Janë lëshuar 71 historiate
- Janë lëshuar 1059 RDPP akte kon. etj.
- Ekipë gjygsore 91
- Janë kryer 378 hipoteka
- Janë dalë në terren 311 herë

Të hyrat për periudhën Janar –Nëntor 2010

REALIZIMI I TE HYRAVE SIPAS DREJTORIVE TE KK GJAKOVË NËNTOR - 2010				
Nr	BURIMET E TË ARDHURAVE	Planifikimi i periudhes Janar-Nëntor - 2010	Realizimi per periudhen Janar-Nëntor 2010	% e realizimit Janar-Nëntor
5	Kadastra	142000	133127.5	93.75%
a	Të hyrat nga shërbimet ka	142000	133127.5	93.75%

Shpenzimet për periudhën Janar –Nëntor 2010

K. ek.	Buxheti sipas kategorive	Buxheti	Alokimet	Mbetet për tu alukuar	Shpenzimet	Zotimet	Mbetja	%,shpe nz. me alokime
	PAGAT	62,096.00	56,631.00	5,465.00	55,710.54	-	920.46	98.37
	M & SHËRBIME	30,871.00	30,871.00	-	28,126.58	2,703.71	40.71	91.11
	KOMUNALIT	10,000.00	10,000.00	-	9,257.34	-	742.66	92.57
	KAPITALE	30,000.00	22,900.00	7,100.00	22,900.00	-	-	100.00
	Gjithsej	132,967.00	120,402.00	12,565.00	115,994.46	2,703.71	1,703.83	96.34

9. DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Spektori për komunikacion:

Për periudhën janar-dhjetor 2010 aktiviteti është fokusuar në këto objektiva:

- ❖ Vendorsjen, mirëmbajtjen dhe rivendosjen e sinjalizimit vertikal në teritorin e komunës së Gjakovës,
- ❖ Mirëmbajtjen e sinjalizimit me drita – semaforëve,
- ❖ Transportin publik të udhëtarëve në trafikun urban dhe periferik,
- ❖ Pregaditjen e projekteve për vendorsjen e sinjalizimit horizontal,
- ❖ Vendorsjen e pengesave në rrugë (policëve të shtrirë) në afërsi të shkollave fillore dhe qerdheve të fëmijëve në komunën e Gjakovës,
- ❖ Vendorsja e shtyllave anti-parkim,
- ❖ Bashkëpunimi dhe takimet e rregullta me PK-njësia e trafikut,
- ❖ Luftimi i dukurive negative në transportin publik të udhëtarëve në bashkëpunim me PK-në,
- ❖ Zgjidhja në kohë e të gjitha kërkesave të qytetarëve të natyrave të ndryshme të cilat kanë të bëjë me lëminë e trafikut,
- ❖ Monitorimi i rezhimit të qarkullimit të automjeteve në vazhdimësi,
- ❖ Pregaditja e rregullores për tërheqjen e automjeteve me marimangë dhe
- ❖ Pregaditjen e pozicioneve për shpalljen e tenderit për:
 - furnizim, vendorsje dhe mirëmbajtje të sinjalizimit vertikal,
 - vendorsjen e shtyllave antiparkim,
 - vendorsjen e sinjalizimit horizontal,
 - mirëmbajtjen e sinjalizimit me drita-semaforave.

INVESTIMET:

- ❖ furnizimi, vendorsja dhe rivendosja e sinjalizimit vertikal, 6.577,⁰⁰ €,
 - ❖ mirëmbajtja e semaforëve 1.520,⁰⁰ €,
 - ❖ vendorsja e pengesave në rrugë 4.520,⁰⁰ €.
- Gjithësejtë 12.617,⁰⁰ €.

TË HYRAT:

- ❖ vazhdimi i lejeve për TAXI 860,⁰⁰ €,

❖ lëshimi i lejeve për TAXI	650, ⁰⁰ €,
❖ leje për qarkullimin e automjeteve me peshë mbi 3.5 t.	960, ⁰⁰ €,
❖ vazhdimi i rrendeve të udhëtimit (për linja të autobusit)	840, ⁰⁰ €,
❖ nga parkingjet	3.447, ⁰⁰ €.
GJITHESEJT:	6.757,⁰⁰ €.

Sektori per energjetikë

- ❖ Mirëmbajtja e Ndriqimit Publikë në gjitha rrugët ku ka linjë të Ndriqimit Publikë në shtylla të metalit dhe të drurit.
- ❖ Pregatitja e materialit vjetor për furnizim dhe mirëmbajtje të ndriqimit publikë e cila duhet të paraqitet për tenderim, tenderimi dhe vazhdimi me punën e matutjeshme.
- ❖ Përciellja e punimeve të kiosqeve në vendosjen e tyre në pikat e caktuara nga urbanizmi - KK me anëtarët e komisionit si kryetare e komisionit
- ❖ Punimi i kërkesës për aplikim të njesorëve të rinjë të vendosur në fshatra me rastin e ndërtimit të Ndriqimit Publikë të rinjë me KEK dhe vazhdimi i kontrollës së Ndriqimit Publikë.
- ❖ Rregullimi dhe definimi i problemeve me njesoret e rinje ne KEK ne bashkpunim me zyrtarin pergjegjes.
- ❖ Kompletimi i dokumentacionit për shtyllat e dëmtuara me rastin e aksidenteve të trafikut dhe përcielljen e tyre te Avokati Publikë.
- ❖ Pregaditja e dokumentacionit per Asociacionin e komunave, dhe GTZ për punimin e projektit të pranuar për donacion nga GTZ.
- ❖ Angazhimi rreth problematikës së dislocimit të linjes ajrore te tensionit te lartë 35 kV në ate tokesore ne rugen “I.Fehmiu” Gjakovë.
- ❖ Angazhimi rreth shpalljes se tenderit për ndriqim publikë eficient të bashkë financuar me GTZ
- ❖ Angazhimi rreth vlerësimit të tenderit “Mirëmbajtja e Ndriqimit Publikë me llampa eficiente në qytetin e Gjakovës” si dhe ritenderimin e tij.
- ❖ Implementimi i Projektit zavendesimi i llampave te zhives 400 W me ato e fluorescente eficiente 250 W ne disa rrugë dhe 150 W në rrugët tjera të qytetit.
- ❖ Ndriqim i ri në rrugën “Petro Nini Laurasi”.
- ❖ Me komisionin në teren për “Zyren e vendit” në fshatin Skivjan – anëtare e komisionit.
- ❖ Përciellja e punimeve ne dislocimin e TS ne fshatin Novosell dhe ndertimi i RRTU per ate lagje.
- ❖ Përciellja e punimeve rreth ndriqimit dekorativ me rastin e festave.
- ❖ Me daten 12 dhe 13 të muajve (Maji, Qershor dhe Korrik) kam marre pjese ne seminar te organizuar ne Prizren nga MEM dhe Eptisa.
- ❖ Me daten 22.04. Seminar me USAID ne Istog .
- ❖ Me daten 21 deri me 26 të 05 kam marre pjese ne seminar te organizuar ne Gjermani të organizuar nga GTZ dhe InWent.
- ❖ Punimi i Përgjigjes së 65 lëndëve apo kërkesave .

Sektori per parqe, tregje dhe varre:

- ❖ Përcjellja e menaxhimit të tregjeve (Orize, Livadhi i Taphaneve, dhe “Ishë Kazerma APJ”),
- ❖ Përcjellja e mirëmbajtjes së gjelbërimit të qytetit dhe mbjelljes së drujve dekorativ,
- ❖ Përcjellja e punimeve në tregun e Rogoves që do të kryhen sipas projektit të prezantuar,
- ❖ Përcjellja e punimeve të rrugëve me zhavor – vazhdon,
- ❖ Përcjellja e punimeve në kanalizimet e ujrave të zeza – vazhdon,

- ❖ Përgjigje në kërkesat e ndryshme të qytetarëve – vazhdon,
- ❖ Pjesmarrje në hapjen dhe vlerësimin e tendereve – vazhdon,
- ❖ Përcjellja e punimeve në rrugët dhe trotualet të cilat do të rregullohen me kubza betoni – vazhdon,
- ❖ Dhenja e pelqimeve për prerjen e disa drujve të demtuar nëpër disa ale të qytetit – vazhdon,
- ❖ Lëshimi i vërtetimitave për tërheqjen e kufomave nga vendet e ndryshme për në R.Kosovës dhe anasjelltas,
- ❖ Pjesmarrje në organizimin e aktiviteteve të ndryshme për mbrojtjen e ambientit në komunën tonë,
- ❖ Përcjellje e Projektit të GLVM i cili pritet të implementohet në vitin 2010-është përfunduar projekti i stacionit transferues të mbeturinave i mbështetur nga REC,
- ❖ Përcjellja e mbeltimit të fidaneve të drujve dekorativ në parqe dhe ale të qytetit,

TE HYRAT:

- ❖ Nga tregjet 15.000,⁰⁰ €,
- ❖ Shpenzimet për sezonin veror dhe vjeshtor për mbjelljen e drunjëve dekorativ 14.920,⁰⁰ €
- ❖ Shpenzimet për mirëmbajtjen e gjelbërimit të qytetit 50.000,⁰⁰ €.

SEKTORI PËR PUNË KOMUNALE:

- ❖ Mirëmbajtjen dimërore të rrugëve Urbane-Rurale 2009/2010 - Vlera 80.000,00 €
- ❖ Përcjellja e punimeve në pastrimin e pushtave të ujërave të zeza dhe atyre atmosferike.
- ❖ Pastrimi kohë pas kohe të lumit “Krena”.
- ❖ Ndërtimi i kanalizimeve të reja neper disa rrugë (Urbane – Rurale) - Vlera 500.000,00 €
- ❖ Janë pranuar kërkesa nga palët për sektor të ambientit (58 lëndë) etj.
- ❖ Takime mujore me WWRO (zyra rregullative për ujë dhe mbeturina).
- ❖ Mirëmbajtja verore e rrugëve urbane (pastrimi), Spërkatja, larja me presion, pastrimi i mbeturinave të ngurta të hedhura nga qytetarët e pandërgjegjshëm si dhe pastrimi i deponive të egra nga ndërmarrja komunale KRM“Çabrat”. Vlera 90.000 €
- ❖ Pastrimi gjeneralë i lumit “Krena”. Vlera 8.000 €
- ❖ Është bërë vlerësimi i tenderave dhe janë përcaktuar ofertuesit:
 - a) “Mirëmbajtja verore e rrugëve urbane”, - “Montcomerci”
 - b) “Ujra të zeza, atmosferike dhe ujë të pijshëm”, “Mula”
 - c) “Ndërtimi i stacionit transferues të mbeturinave”, faza e 2, nga OJQ REC-u Prishtinë - fitues “Montcomerci” etj.
- ❖ Zgjedhja e ofertuesit për”Mirëmbajtjen dimërore të rrugëve Urbane-Rurale” me kripë të sigurimit nga kompania për vitin 2010/2011

Të hyrat për periudhën Janar –Nëntor 2010

REALIZIMI I TE HYRAVE SIPAS DREJTORIVE TE KK GJAKOVË NËNTOR - 2010				
Nr	BURIMET E TË ARDHURAVE	Planifikimi i periudhes Janar-Nëntor - 2010	Realizimi per periudhen Janar-Nëntor 2010	% e realizimit Janar-Nëntor
2	Drejtoria e Sherbimeve Publike	183,000.00	124,946.00	68.28%
	Denimet nga trafiku	134,300.00	86,400.00	64.33%
a	Denim ne trafik qe percjellen nga MEFI	131,000.00	85,605.00	65.35%
b	Denim ne trafik -sekuestr.automjeteve	3,300.00	795.00	24.09%
c	Lejet e perkohshme për shfrytëzimin e rrugës	500.00	-	0.00%
d	Të hyrat nga parkingjet	4,500.00	2,635.00	58.56%
e	Leje për taxi - vijat e autobusëve	3,200.00	4,400.00	137.50%
e	Të hyrat nga tregjet	39,500.00	11,540.00	29.22%
f	Shitja e kerreve	1,000.00	19,971.00	1997.10%

Shpenzimet për periudhën Janar –Nëntor 2010

K. ek.	Buxheti sipas kategorive	Buxheti	Alokimet	Mbetet për tu alikuar	Shpenzimet	Zotimet	Mbetja	%,shpe nz. me alokime
	PAGAT	249,144.00	227,519.20	21,624.80	227,480.92	-	38.28	99.98
	M & SHËRBIME	113,688.00	113,688.00	-	108,225.76	5,461.60	0.64	95.20
	KOMUNALI	15,000.00	15,000.00	-	12,892.04	0.01	2,107.95	85.95
	KAPITALE	1,007,962.00	957,918.50	50,043.50	944,279.57	5,011.17	8,627.76	98.58
	DONACION	13,136.72	13,136.72	-	11,988.00	-	1,148.72	91.26
	Gjithsej	1,398,930.72	1,327,262.42	71,668.30	1,304,866.29	10,472.78	11,923.35	98.31

10. DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM

DMSH-ja për hartimin e këtij raporti të shkurtër ka përzgjedhur të paraqes statistika, diagrame dhe disa punë dhe aktivitete të cilat kanë qenë të një rëndësie të veçantë:

	Aktiviteti	Lëndë/aktivitete
1	Lëndët e DMSH-së, të administruara në periudhën raportuese	350
2	Koordinimi dhe menaxhimi i rasteve përmes QAKE-112	553
3	Reagimi në zjarrfikëje dhe emergjenca teknike	504
4	Inspektimi në lëmin e mbrojtjes nga zjarri	84
5	Intervenime të specializuara	6
6	Aksione për eliminimin e rrezikut nga qentë endacak	52
7	Asistenca e sigurisë humane	191
8	Sigurimi dhe shpërndarja e ushqimit dhe veshmbathjes për familjet që kanë pësuar në vërshimet	4
9	Intervenime jashtë komunës	6

✚ Më poshtë përshkruajmë disa nga aktivitetet e DMSH-së:

- Mbajtja e takimeve të rregullta javore të zyrtarëve të DMSH-së (gjatë vitit)
- Kontributi në ndërtimin e Urës në rr.”S. Stavileci” me donacion të KFOR-Hungarez.
- Ngritja e bashkëpunimit me Departamentin e Menaxhimit të Emergjencave MPB (Mars)
- Krijimi i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi (janar), dhe certifikimi i 36 anëtarëve nga Departamenti i Drejtësisë Amerikane.
- ✓ Angazhimi në vërshimet e mëdha në Shkodër & Lezhë (Shkurt)
- ✓ Në aksionet për largimin e rrezikut nga kafshimi i qenve endacak, janë eliminimin 458 qenve endacak
- ✓ Grumbullimi i radiolidhjeve nga bashkëpunëtorët e QAKE-112
- ✓ Angazhimi në Zjarret e mëdha në Bajram Curri (Gusht)
- ✓ De-blokimi emergjent i rrugëve nga bora dhe rrëshqitjet e dheut (Gjate vitit 2010)
- ✓ Angazhimi i zhytësve në fatkeqësi ujore (Mitrovicë, Kline, Peje dhe Podujevë).
- ✓ Intervenimet emergjente gjatë 4 vërshimeve në komune (Gjate vitit 2010)
- ✓ Dhënia e ndihmave familjeve të vërshuar në katër vërshimet e vitit 2010
- ✓ Hartimi i Planit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë(2010)
- ✓ Mbajtja e Kampit “Antizjarri 2010” në fshatin Damjan (Korrik-Gusht)
- ✓ Organizimi i takimit të Drejtorive homologe të Rrafshit të Dukagjinit (Tetor)

- ✓ Krijimi i strukturës së partnerëve kontribuues në emergjenca në çështje si :zjarre, vërshime etj.
- ✓ Angazhimi dhe kontributi i vazhdueshëm i Drejtorit të DMSH, dhe zyrtarit për siguri në Këshillin Komunal për Siguri të Bashkësisë.
- ✓ Fillimi i bashkëpunimit me Brigadën për Ndërhyrje emergjente të Forcës së Sigurisë së Kosovës,
- ✓ Angazhimi i zyrtarëve të DMSH-së, në struktura të ndryshme komunale me rëndësi të përgjithshme,
- ✓ Angazhimi i zyrtarit për siguri në protokollin zyrtar komunal në të gjitha organizimet komunale,
- ✓ Pjesëmarrja e zyrtarëve në trajnime të ndryshme me qëllim të ngritjes së kapaciteteve profesionale,
- ✓ Trajnimet e ndryshme profesionale dhe kondicionale të zjarrfikësve,
- ✓ Angazhimi i vazhdueshëm në mbajtjen në gatishmëri të automjeteve motorike të zjarrfikjes,
- ✓ Grumbullimi i kontejnerëve nga fshati Slloven me ndihmën e policisë.

Donacionet të cilat janë siguruar nga donatorët e ndryshëm, e të cilat janë me interes komunal dhe profesional

#	Donacionet e pranuar	Donatori
1	Ndërtimi i Urës ne Rr.”Sadik Stavileci”	KFOR -Hungarez
2	Ndërtimi i Urës tek Spitali	KFOR -Hungarez
3	Veshmbathje dhe ushqim për 30 familje te vërshuara	KFOR -Hungarez
4	Pajisje profesionale për fitnes për zjarrfiksa	KFOR -Hungarez
5	Aparate për ftohjen e ujit te pijes	KFOR -Hungarez
6	2000 Kg, pluhur për fikjen e zjarrit	KFOR -Hungarez
7	100 rrypa profesional, 10 xhemper, 5 pale çizme	Milano Itali
8	Dy kamionë sulmues “Denis”	Rotary Club-Angli
9	Dy kombi bus “Ford” pe veprime emergjente	Rotary Club-Angli
10	Një automjet terreni “Isuzu” Trooper	Rotary Club-Angli
11	Pajisje dhe veshmbathje për mbrojtje nga zjarri	Rotary Club-Angli
		Total:

#	Donacionet e dhuruara	Dhuruar
1	Kamion sulmues i kombinuar “Mercedes”	Bajram Curri
2	Uniforma dhe Pajisje kunder zjarrit	Komuna Junik
		Total:

Sfidat e Drejtorisë për vitin 2010:

- ✓ Marrja jo-ligjore e telefonisë emergjente mobile 112 dhe transferimi i saj ne Peje.
- ✓ Strukturimi i gjuetarit per eliminimin e qenve endacak,
- ✓ Finalizimi i procesit te tenderimit per kompanine kontraktuese per rastet emergjente.
- ✓ Mungesa e fondit per ndihme emergjente ne strehim, ushqim, veshembathje etj.
- ✓ Mungesa e “Dhomes Emergjente”, me pajisje te sofistikuara per koordinim dhe menaxhim.
- ✓ Mungesa e mjeteve buxhetore per mallra dhe sherbime ne kuoten 30% per shkak te rritjes se numrit te automjeteve dhe objekteve.
- ✓ Mënjanimi materialit te rrezikshëm Kimik-Biologjik nga fabrikat “E.Duraku” dhe “Metaliku”

11. DREJTORIA PËR PUNË INSPEKTUESE

Nr. rend.	Emertimi i lëndës	Sasia	Nr. rendor nga libri intern
1	Aktvendimi	1786	
2	Kërkesa për inicim proced. kundërvaj.	307	
3	Kallzime penale	1	
4	Lëndë të zgjidhura	275	
5	Lëndë të pazgjidhura		
6	Të hyra vetanake në KK Gjakovës		
7	Të hyra në buxhetin e konsoliduar Kosovës	8.400,00	
8	Mall i konfiskuar për shkak të skadimit	29.507 kg/lit	Artikuj të ndryshëm ushqimor dhe joushqimor
9	Mall i konfiskuar për shkak dokumentacionit	100.862 njësi të ndryshme	
10	procesverbalet	5861	

Nga dt.01.03.2010 ka filluar aksioni për largimin e mallrave të ekspozuar para objekteve afariste dhe lirimin e hapësirave publike për qarkullim të lirë të kalimtarëve si dhe mbrojtjen e mallit e sidomos atij ushqimorë që është i ndieshëm në kushtet atmosferike.

Fillimishtë aksioni ka qenë shumë i suksesshëm mirpo për shkak të mosefikasitetit të Gjykatës Komonale për kundërvajtje ende i kemi disa raste të cilat nuk e respektojnë urdhresen e inspektorve përkundër që ndaj tyre kemi iniciuar procedura kundërvajtëse dhe e kemi konfiskuar një sasi të konsiderueshme të mallrave të ndryshëm si tekstil,këpucë dhe galanteri të lëkurës dhe artikuj ushqimorë dhe barna humane.

Me qëllim të njoftimit dhe sensibilizimit, janë njoftuar dhe urrdhëruar të gjitha subjektet afariste hoteliere dhe tregëtare, institucionet komunale publike, parashkollë, shkollave fillore, të mesme si dhe ato të larta, institucionet shëndetësore në lidhje me ligjet mbi duhanin dhe rregulloret komunale.

Ky aksion është organizuar nga Drejtoria e inspeksionit në bashkëpunim me shoqërinë civile dhe në përcjellje të mediave si të shkruara dhe ato elektronike, ku me këtë rast janë shpërndarë afishe të ndryshme dhe material për parandalimin e konsumimit të duhanit dhe alkoolit sidomos për moshat nën 18 vjeq, si dhe masat ndëshkuese sipas legjislacionit në fuqi.

Aksioni ka zgjatë një javë.

Janë kontrolluar pikat e shitjes së derivateve të naftës (Pompave të benzines),ku janë verifikuar paisja e tyre me dokumentacion ,verifikimi i bazhdarimit të paisjes nga ana e kompanive të licencuara ,gjendja e rezervave në rezervuar, janë regjistruar numrat e totalizatorëve ,saktësia e toqitjes së derivateve është verifikuar gjendja e aparatures pasive dhe aktive si dhe prezenca e ujit në rezervuar..

Kontrollimi ka rezultuar përveq efekteve tjera edhe me paisjen e këtyre pikave me Leje Pune dhe aplikime për legalizime të ndërtimit të objekteve si dhe derdhjen e një shume të konsiderueshme të mjeteve në Buxhetin e Komunës.

Nga 37 pikat e shitjes si në qytet e poashtu në pjesët rurale në momentin e kontrollës vetëm 17 kanë qenë të paisura me Leje Pune ,13 me Licencë nga MTI-ja ,mirpo pas ujdhesës së inspektorve të gjitha janë paisur me leje pune si dhe licenca përveq rasteve ku kjo gjë është

pamundësuar për shkakë të problemeve me leje të ndërtimit sepse nga 37 pikat vetëm 11 kanë qenë të ndërtuara me Leje ndërtimi.

Në 10 raste kemi pasë toqitje të derivateve më pak se ka regjistruar totalizatori gjë që është përmirësuar pas intervenimit të Entit të Metrologjisë legale të Kosovës me seli në Prizren me kërkesë të inspeksionit, ndërsa në asnjë rast nuk kemi hasë prezencë të ujit në rezervuar.

Për nder të ditës ndërkombëtare të planetit “Tokë” 22 Prill, kemi organizuar manifestime të ndryshme në qytet, duke u përpjekur për vetëdijsimin e qytetarve, për mbrojtjen e mjedisit, ku kanë marrë pjesë edhe nxënës të shkollave fillore dhe të mesme, në disa pastrime simbolike nëpër disa rrugë të qytetit dhe në fundë të aksionit është bërë mbaltimi i disa fidaneve në parkun qendror të qytetit.

Kemi vendosur shenjat për ndalimin e huthjes së mbeturinave në disa lokacione për një ambient më të përshtatshëm si psh. në fshatin Shkugës, Raqë etj.

Monitorimi i vazhdueshëm i lumit “Krena” me rastin e fillimit të pastrimit gjeneral të shtratit të ndërtuar (korites) të këtij lumi nga firma “Tini”.

Kemi bërë përcjelljen për qdo ditë rrethë pastrimit gjeneral nga mbeturinat të shtratit të ndërtuar të lumit “Krena” që është bërë nga firma “Tini” ku dhe kemi japë vërejtjet tona direkte dhe për disa pjesë që duhet të pastrohen të cilat edhe i kanë kryer.

Të autorizuar nga zyra e kryetarit të komunës, kemi përcjellë pranimin e punimeve në mbylljen e deponisë së qytetit, projekt ky i financuar nga komisioni European e i implementuar nga një kompani Greke.

Me ftesë të OJQ-ve “Iniciativa e femrës kosovare” dhe “Ekolëvizja” kemi marrë pjesë në fushatën një ditore të organizuar nga këto OJQ me shënimin e javës ndërkombëtare pa mbeturina. Kjo fushatë në Gjakovë është organizuar me dt. 14.10.2010 në vendin e quajtur Shkugëz dhe është udhëhequr me moton “sot pastrova unë ti kur?”, pjesëmarrës në këtë aksion ishin disa nxënës të shkollave të mesme të komunës tonë.

Duke u bazuar në dukurinë e kohës së fundit të shtimit të zgarave për pjekjen e pulave, ankesave të popullatës si dhe ndotjes së ambientit nga tymi i këtyre zgarave, Drejtoria e inspeksionit ka formuar komisionin në përbërje të një inspektori të mbrojtjes së mjedisit, një inspektori sanitar, një inspektori komunal si dhe një inspektori të tregut që secili në kuadër të kompetencave të veta të verifikoi veprimtarinë.

Pas verifikimit nga ana e komisionit dhe afatit të dhënë për pajisje me pëlqim nga ana e Drejtorisë së planifikimit hapësinor urban dhe rural, komisioni ka ndërprerë verpimtarinë e 5 zgarave për pjekjen e pulave dhe ka bërë largimin fizik të tyre.

Nga data 01.05.2010 inspeksioni ka intensifikuar verpimet rreth parandalimit të hedhjes së mbeturinave në hapësirat që nuk janë të parapara si deponi të mbeturinave, hedhjes së mbeturinave në lumenj dhe jashtë kontejnerëve.

Për parandalimin e kësaj dukurie janë vendosur kujdestari jashtë orarit të punës si dhe ditëve të pushimit dhe ndaj shkelësve të urrdhëresës është vepruar sipas legjislacionit në fuqi me kërkesa për iniciimin e procedurës kundërvajtëse dhe me gjobitje.

Është punuar në lidhje me pajisjen e subjekteve afariste me pëlqim për shfrytëzim të hapësirave publike me karriga dhe tavolina si dhe me pano dhe reklama të ndryshme është arritë që një numër i konsiderueshëm i tyre të pajisen me pëlqime si dhe të derdhet një shumë e madhe e të hyrave në buxhetin e komunës.

Janë konfiskuar në bazë të disa aksioneve dhe asgjësuar 615 kg. mish për shkak të mosplotësimit të kushteve të automjetit transportues (temperatura ka qenë më e lartë se ajo e lejuar me ligjë). Asgjasimi është bërë në deponin e mbeturinave të qytetit duke i përmbushë dispozitat e parapara të legjislacionit në fuqi në prezencë të policisë së Kosovës si dhe njësitit kundër krimeve ekonomike regjioni i Pejës.

Janë groposur rreth 700 qenë endacak në deponin e qytetit duke respektuar procedurat veterinare.

Inspeksioni i ndërtimtarisë si detyrë primare ka pasur parandalimin e ndërtimeve të egra, kontrollimet kanë qenë permanente si dhe ditëve të pushimit është bërë kujdestari.

Përkundër rënjes së intensitetit të ndërtimeve pa leje ndërtimi inspeksioni ka lëshuar aktvendime për ndalim të punimeve, janë iniciuar kërkesa për kundërvajtje dhe aktvendime për kthim të rasteve në gjendje të mëparshme.

Janë bërë 2 rrëime të objekteve afariste të cilat kanë uzurpuar hapësirë publike.

Janë kontrolluar objektet hoteliere në lidhje me vazhdimin e orarit të punës, kushteve të përgjithshme higjieno-sanitare, kontrollimet shëndetësore të personelit si dhe gjendja e ushqimit e sidomos prejardhja e mishit për shkak të tendencës së hotelierëve që të shërbejnë mysafirët me mish të importuar me dedikim vetëm për përpunim e jo për konsum.

Sektore të ndryshme të këtij drejtorati kanë verifikuar afatin e përdorimit të artikujve ushqimorë dhe barërave humane si dhe kommentacionin e prejardhjes së mallit dhe me këtë rast është ngritë një kallxim penal ndaj një subjekti afarist dhe është iniciuar procedura kundërvajtëse ndaj disa subjekteve afariste si për skadim të afatit e gjithashtu për shkak të dokumentacionit jo të rregullt, është konfiskuar dhe asgjësuar një sasi e konsiderueshme e artikujve ushqimorë dhe barërave humane.

Mali i konfiskuar dhe asgjësuar është 29.507 kg/litër apo 100.862 njësi artikuj të ndryshëm.

Të hyrat për periudhën Janar – Nëntor – 2010

REALIZIMI I TE HYRAVE SIPAS DREJTORIVE TE KK GJAKOVE NENTOR - 2010				
Nr	BURIMET E TË ARDHURAVE	Planifikimi i periudhes Janar-Nëntor - 2010	Realizimi per periudhen Janar-Nëntor 2010	% e realizimit Janar-Nëntor
3	Drejtoria e Inspekcioni	61,300.00	62,782.70	102.42%
a	Denimet nga Inspekcioni -	28,500.00	22,252.70	78.08%
b	Lejet për plotsimin e kusht	23,500.00	25,265.00	107.51%
c	Sherbimi - pije alkoolike	9,300.00	15,265.00	164.14%

Shpenzimet për periudhën Janar – Nëntor – 2010

K. ek.	Buxheti sipas kategorive	Buxheti	Alokimet	Mbetet për tu alukuar	Shpenzime t	Zotimet	Mbetja	%,shpenz. me alokime
	PAGAT	80,706.00	73,811.40	6,894.60	74,096.19	-	(284.79)	100.39
	M & SHËRBIME	24,087.00	24,087.00	-	19,421.66	4,659.55	4,665.34	80.63
	KAPITALE	50,000.00	-	50,000.00	-	-	-	#DIV/0!
	Gjithsej	154,793.00	97,898.40	56,894.60	93,517.85	4,659.55	4,380.55	95.53

12. DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

Gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2010 në Drejtorin e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale punët dhe aktivitet kryesore kanë qenë:

- Gjithsejtë rreth 600.000 shërbime të ndryshme shëndetësore.
- Janë arkëtuar 60.000 €. nga participimi i qytetarëve.
- Është arritur të bëhet punësimi pesëmbëdhjetë (15) mjekëve të rinj në punë.

Nga investimet kapitale janë arritur të bëhen:

- Renovimi i ambulancës në fsh. Dujakë – rreth 20.000€
- Ndërtimi i QMF-së “ E. Duraku “ në Gjakovë rreth 70.000€.
- Janë blerë tri (3) automjete - për Drejtorin e Shëndetësisë, QKMF dhe QPS mbi 45.000€.
- Është përfunduar ndërtimi dhe është përfunduar Objekti i Banimit Social (investim i MPMS) rreth 550.000 €.
- Është bërë përzgjedhja e 25 familjeve të pastrehuara dhe në gjendje të rëndë sociale dhe gjatë muajit Tetor janë sistemuar në ndërtesën në fjalë.
- Nga programi i subvencioneve janë ndihmuar njëqind e pesëdhjetë (150) pacient me sëmundje të rënda në vlerë prej 50.000 €.
- Në qendrën për Punë Sociale rregullisht ndihmohen rreth 1400 familje nga programi i Ministrisë së Mirëqenës Sociale.
- Është arritur që pas 11 viteve të mbyllet banimi kolektiv në fh. Slloven. ku kushtet e banimit nuk kanë qenë aspak njerëzore.
- Janë pranuar dhe trajtuar rreth 500 lëndë të ndryshme.

Të hyrat për periudhën Janar – Nëntor – 2010

REALIZIMI I TE HYRAVE SIPAS DREJTORIVE TE KK GJAKOVE NENTOR - 2010				
Nr	BURIMET E TË ARDHURAVE	Planifikimi i periudhes Janar-Nëntor - 2010	Realizimi per periudhen Janar-Nëntor 2010	% e realizimit Janar-Nëntor
14	SHENDETËSIA	47,100.00	52,658.00	111.80%

Shpenzimet për periudhën Janar – Nëntor – 2010

Buxheti sipas kategorive	Buxheti	Alokimet	Mbetet për tu alukuar	Shpenzimet	Zotimet	Mbetja	%,shpenz. me alokime
PAGAT	1,452,829.00	1,340,784.57	112,044.43	1,338,442.37	-	2,342.20	99.83
M & SHËRBIME	190,495.50	190,495.50	-	166,167.98	24,321.34	6.18	87.23
KOMUNALIT	57,000.00	57,000.00	-	50,465.66	0.46	6,533.88	88.54
SUBVENCIONE	50,000.00	50,000.00	-	50,000.00	-	-	-
KAPITALET	133,781.00	133,781.00	-	60,671.75	73,109.25	-	45.35
Gjithsej	1,884,105.50	1,772,061.07	112,044.43	1,665,747.76	97,431.05	8,882.26	94.00

Gjakovë, dhjetor 2010

**Kryetari i Komunës,
Dr. Pal Lekaj**